- Në takimin e mbajtur me 29.03.2018 Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Hidroregjioni Jugor" Sh. A me seli në Prizren në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për Raportet mbi Përbushjen e Nevojave të Klientëve dhe nenin 16 Ligji Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, pas shqyrtimit të bërë njëzëri **miratoi** raportin mbi Hulumtimin e Kënaqshmërisë së Konsumatorëve për periudhën janar-dhjetor 2017 në zonën e shërbimit të cilën e mbulon KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A Prizren.
- Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me 30.04.2018 në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, pas shqyrtimit të bërë njëzëri **miratoi** Raportin Operativ dhe Financiar të TM1 për vitin 2018. Vërejtje e Bordit ishte që të ardhmen të arrihen caqet dhe objektivat e planifikuara në plan biznes dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Auditori i Brendshëm në raportet e auditimit.
- Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me 30.04.2018 bëri vlerësimin e kryerjes së detyrave të punës për Zyrtarët e Lartë të Kompanisë për vitin 2017: Kryeshefin Ekzekutiv, Zyrtarin Kryesor Financiar, Sekretaren e Kompanisë ndërsa nga Komisioni i Auditimit u vlerësua Auditori i Brendshëm i Kompanisë.
- Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 01.06.2018 me rekomandim të Komisionit të Auditimit dhe pas shqyrtimit të raportit janar-prill 2018 te prezantuar nga Zyrtari për raportim **miratoi** raportin e performancës për muajin Prill 2018.
- Bordi i Drejtorëve në Mbledhjen e Përgjithëshme Vjetore me Aksionarin me datë 28.06.2018 i **miratoi** Pasqyrat Financiare të Audituar nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2017.
- Bordi i Drejtorëve në Mbledhjen e Përgjithëshme Vjetore me Aksionarin me datë 28.06.2018 **miratoi** Raportin vjetor për vitin 2017
- Bordi i Drejtorëve në Mbledhjen e Përgjithëshme Vjetore me Aksionarin me datë 28.06.2018 **miratoi** Performancën e Menaxhmentit të Kompanisë për vitin 2017.
- Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Hidroregjioni Jugor" Sh. A me seli në Prizren në përputhje me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, për Plan-Biznes në takimin e mbajtur me datë 30.07.2018 njëzëri miratoi revidimin e Planit të biznesit për vitin 2018 ndërsa të dhënat e planifikuara për vitin 2019 dhe 2020 te plotësohen, ndryshohen gjatë planifikimeve vjetore dhe aplikimit tarifor në pajtim me ARRU.
- Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Hidroregjioni Jugor" Sh. A me seli në Prizren, në takimin e mbajtur me datë 30.07.2018 në përputhje me nenin 7. pika 2. të Statutit të KRU "Hidroregjioni Jugor" pas shqyrtimit të bërë njëzëri **miratoi** "Rregulloren e brendshme për menaxhim të aseteve të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Hidroregjioni Jugor" Sh. A.- Prizren.
- Në takimin e datës 27.08.2018 në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve i K. R. U "Hidroregjioni Jugor" Sh. A, pas shqyrtimit të bërë njëzëri miratoi Raportin Operativ dhe Financiar të TM2 për vitin 2018.
- Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me 27.08.2018 pas shqyrtimit të bërë miratoi raportin e performancës operative dhe financiare të Kompanisë për muajin korrik 2018 .

- Bordi i Drejtoreve në takimin e mbajtur me 27.08.2018 pas shqyrtimit të kërkesës së ZKF miratoi njëzëri dorëheqjen nga detyra të Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit z.Liman Gashi. Bordi rekomandoi Kryeshefin Ekzekutiv që z. Liman Gashi të sistemohet në pozitë apo vend tjetër të punës në Kompani.
- Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Hidroregjioni Jugor” Sh. A me seli në Prizren, në bazë të Nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Ligji Nr. 03/L-087, si dhe duke u bazuar në propozimin e Kryeshefit Ekzekutiv, mori vendim që të emërohet z. Asllan Zejnullahu Ushtrues Detyre i Zyrtarit Kryesor Financiar dhe i Thesarit të KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh. A me seli në Prizren deri në zgjedhjen e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit me Konkurs publik sipas Ligjit të NP dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.
- Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Hidroregjioni Jugor” Sh. A me seli në Prizren, në bazë të Nenit 21.4 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren mori **vendim** të publikoj konkursin publik për pozitën e punës së Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit duke u mbështetur në procedurat e parapara në Ligjin e Ndërmarrjeve Publike Ligji Nr. 03/L-087 dhe në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.
- Në takimin e mbajtur me datë 01.10.2018 në përputhje me nenin 20 dhe 22 të Ligjit Nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike dhe Neni 12 të ligjit Nr. 04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, për Politikën e Kompensimit për stimulimin e efektshmërisë në bazë të performancës për Bordin e Drejtorëve dhe Zyrtarët e KRU “Hidroregjioni Jugor”Sh.A Bordi i Drejtorëve **Aprovoj** njëzëri Deklaratën për politiken e Kompensimit për Drejtorët e Bordit dhe Zyrtarët e KRU“Hidroregjionit Jugor “sh.a për vitin 2017 pasi e njëjta është aprovuar në Komision të Auditimit në takimin e dt. 28.09.2018.
- Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 01.10.2018 pas shqyrtimit të bërë njëzëri miratoi raportin e performancës financiare të Kompanisë për muajin gusht 2018.
- Më datën 04.10.2018 është mbajtur takimi i Bordit për kryer intervistën me kandidatet e përzgjedhur apo selektuar nga Bordi i Drejtorëve për pozitën e punës Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit në KRU“Hidroregjioni Jugor” Sh. A ne Prizren. Pasi që nuk janë plotësuar kushtet për intervistë dhe përzgjedhjen kandidatit për Zyrtar Kryesor Financiar dhe i thesarit Bordi i drejtorëve i KRU“Hidroregjionit Jugor”Sh.A, njëzëri nga të pranishmit u mor vendim që të anulohet konkursi për Zyrtar Kryesor Financiar dhe i thesarit të publikuar 2(dy) here në shtypin ditor “Zëri” dhe “Epoka e re” të datës 29.08.2018 dhe 07.09.2018. Anulimi është bërë për shkak të mos plotësimit të kushteve të parapara me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative të K. R. U“Hidroregjionit Jugor”sh.a, Prizren. Bordi i drejtorëve vendosi që Anulimi i konkursit të publikohet në shtypin ditor, njëherit kërkoj që i njëjti të rishpallet në ditët në vijim.
- Bordi i Drejtoreve në takimin e mbajtur me datë 26.10.2018 në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, pas shqyrtimit të bërë njëzëri **miratoi** Raportin Operativ dhe Financiar të TM3 për vitin 2018 .
- Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit“Hidroregjioni Jugor”Sh.A me seli në Prizren në takimin e mbajtur me datë 26.10.2018 në përputhje me nenin 30 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për Plan-Biznes, pas shqyrtimit të bërë **miratoi** Plan-Biznesin për vitin 2019-2021 .

- Në takimin e mbajtur me datë 26.10.2018 Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjiellit "Hidroregjioni Jugor" Sh.A pas diskutimit lidhur me propozimin për krijimin e departamentit për trajtimin e ujërave të zeza mori vendim të **miratoi** propozim-kërkesën për krijimin e Departamentit për trajtimin e ujërave të zeza me plotësim ndryshimin Oganogramit të kompanisë. Detyrat dhe përgjegjësit e punonjësve të Departamentit për trajtimin e ujërave të zeza të jenë pjesë përbërëse të Rregullores mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Kompanisë Rajonale të Ujësjiellit "Hidroregjioni Jugor" Sh. A. Prizren.
- Në takimin e mbajtur me datë 26.10.2018, nga anëtarët e Bordit të drejtorëve u nënshkrua **Vendim** për kredi në NLB për blerjen e 5 veturave të reja për shërbimet e Kompanisë. Shuma e kredisë është 30.000.00 euro. Vlera totale e blerjes së veturave është 60.000.00 euro dhe nga banka kërkohet që të financohet me 50% të vlerës totale.
- Në takimin e mbajtur me datë 26.10.2018 Bordi i Drejtorëve në përputhje me nenin 7. pika 2. të Statutit të KRU "Hidroregjioni Jugor" pas shqyrtimit të bërë **aprovoj** njëzëri pa vërejtje "Udhëzuesin për menaxhimin e borxheve në sektorin e shërbimeve të ujit me politikën dhe procedurat për menaxhimin e borxheve të KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A Prizren".
- Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me 14.11.2018 në përbërje të plotë ka kryer hapjen dhe shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve të cilët kanë konkurruar për pozitën e punës Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit në Kompanisë Rajonale të Ujësjiellit "Hidroregjioni Jugor" Sh. A, Prizren, sipas Konkursit të rishpallur në shtypin ditor "Zëri" dhe "Epoka e re" të datës 10.10.2018.
- Bordi i drejtorëve mbajti takimin me datë 19.11.2018 për të intervistuar dhe vlerësuar kandidatet e përzgjedhur nga lista e ngusht me datë 14.11.2018 për pozitën e punës Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit në KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh. A në Prizren.
- Në takimin e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me 27.11.2018 u shqyrtua kërkesa e Menaxherit Rajonal për konsumator lidhur me ndryshimin e organogramit të shërbimit me konsumator. Bordi i Drejtorëve pas shqyrtimit të kërkesës së Menaxherit Rajonal për konsumator lidhur me ndryshimin e organogramit të shërbimit me konsumator vendosi që kjo kërkesë dhe nëse ka edhe kërkesa tjera në këtë drejtim të shqyrtohen në kohën e revidimit të Plan-biznesit. Bordi propozoi Kryeshefit Ekzekutiv që të formohet komision nga të gjitha shërbimet e Kompanisë që të punojnë në plotësim ndryshim të organogramit të Kompanisë e që kjo reflekton edhe në ndryshim të rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Kompani.
- Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjiellit "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren me seli në Prizren, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2018 pas shqyrtimit të bërë njëzëri **miratoi** "Planin afatgjatë të investimeve për 2019-2028" në KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren.

Aktivitetet tjera të Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2018

- Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2018 ishte në kontakte të vazhdueshme me Menaxhmentin e Kompanisë.
- Në vazhdimësi ka kërkuar dhe është njoftuar, në kontakte direkte por edhe në formë të shkruar, për gjendjen dhe zhvillimet në kompani.

- Është mbikqyrë menaxhimi kompanisë dhe janë dhënë këshillat e nevojshme për Kryeshefin Ekzekutiv.
- Në takimet e rregullta janë mbikqyrë të gjitha ecuritë e biznesit, mbarëvajtja e tyre sipas vendimeve të Bordit si dhe aspekti ligjorë i vendimeve të Menaxhmentit të kompanisë. Lidhur me këtë Bordi i Drejtorëve është i informuar për të gjitha vendimet dhe zhvillimet e rëndësishme.
- Është bërë shqyrtimi dhe aprovimi i raporteve tremujore për vitin 2018 (duke u bazuar në raportet mujore); dhe në kornizën ligjore të Ligjit për NP.
- Janë dorëzuar të aprovuara raportet si në vijim: Raporte tremujore për aksionarin (MZHE); (nga raporti TM1 deri te raporti për TM4) dhe raporte mujore për ARRU-në.
- Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2018 i ka mbajtur 15 takime të rregullta me përbërje të plotë.
- Në kuadër të Bordit të drejtorëve kanë vazhduar të funksionojnë këto komitete;
 1. Komisioni i Auditimit (08 Takime)
 2. Komiteti për Staf dhe Shbërblime (01 takim)
 3. Komiteti i Financave (0 Takime)
 4. Komiteti për hulumtime dhe teknologji (0 Takime)

Bordi i Drejtorëve falënderon Kryeshefin Ekzekutiv, stafin menaxhues të Kompanisë dhe gjithë punëtorët për për angazhimin e tyre në rritjen e performancave të kompanisë dhe në përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve. Bordi shprehë një mirënjohje të veçantë për të gjithë donatorët (KFW, Dorsch-CDI), MZHE dhe Komunitat për bashkëpunim dhe mbështetje në realizimin e shumë projekteve për në interes të Kompanisë.

Aktivitetet nga Komisioni i Auditimit gjatë vitit 2018

Komisioni i Auditimit ka mbajtur tetë (08) takime të rregullta, sipas procesverbaleve takimet janë mbajtur ne këto data: 23.01.2018; 26.02.2018; 27.03.2018; 26.04.2018; 28.05.2018; 27.07.2018; 28.09.2018; dhe 23.10.2018;

Raporti vjetor i Komisionit të Auditimit, të KRU" Hidroregjioni Jugor"sh.a në Prizren, në formë përmbledhëse përfshinë aktivitetet dhe punët të cilat i ka realizuar gjatë vitit 2018.

Bazë apo burim i të dhënave gjatë përgatitjes së këtij raporti vjetor, janë procesverbalet zyrtare të mbajtura në takimet e Komisionit të Auditimit.

Komisioni i Auditimit gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithësej tetë (08) takime të rregullta, ndërsa shumë çështje tjera janë shqyrtuar drejtëpërdrejt në takimet e rregullta të Bordit të Drejtorëve.

Në vazhdim, në mënyrë kronologjike, në formë të përgjithësuar, janë të paraqitura takimet, aktivitetet, diskutimet, konkluzionet dhe vendimet e Komisionit të Auditimit.

Në takimin e parë të vitit 2018, të mbajtur me 23.01.2018 nga Komisioni i Auditimit, është diskutuar dhe analizuar:

- Raporti i performancës operative dhe financiare të KRU Hidroregjioni Jugor për TM4 2017,

- Shqyrtimi i raportit vjetor të performancës operative dhe financiare të KRU Hidroregjioni Jugor, 2017,
- Raporti për regjistrimin e stokeve dhe te tjerave te kompanisë për vitin 2017,
- Shqyrtimi i raporteve te aktiviteteve nga zyra për konsumator për vitin 2017,
- Raport nga zyra e Prokurimit për te gjitha aktivitetet ne vitin 2017 dhe plani operativ për vitin 2018 ,
- Raporti nga Auditori i brendshëm për TM4 2017,
- Raporti vjetor nga Auditori i brendshëm për vitin 2017.

Konkluzionet dhe vendimet e marra të K.A gjatë këtij takimi kanë qenë:

- Komisioni i Auditimit kërkoj nga të gjithë udhëheqësit e njësive punuese që të kenë kujdes në shpenzime te derivateve dhe shpenzimet e tjera si dhe punojnë për rritje te inkasimit dhe rritje te efikasitetit te punës.
- Komisioni i Auditimit kërkoj që për takim të Bordit të paraqitet raport për rastet ne përmbarrim gjatë vitit 2017, kontratat që janë bërë, sa janë duke iu përmbajtur konsumatorët kontratave të pagesës së borxhit dhe sa ka pasur të hyra vjetore nga këto lëndë për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.
- Komisioni i Auditimit kërkoj nga shërbimi i konsumatoreve listën e borxheve për shërbimet e ujit për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.
- Komisioni i Auditimit kërkoj nga Zyrtari i Prokurimit që për takim të radhës të Bordit të Drejtorëve të paraqiten deklaratat e nevojave për të gjithë tenderët e zhvilluar gjatë vitit 2017 si dhe kopjet e procedurave për aneks kontratat e lidhura përmes CDI.
- Komisioni i Auditimit njëzëri Aprovoj Raportin e TM4 të Punës së Auditorit të Brendshëm, për vitin 2017.
- Komisioni i Auditimit njëzëri Aprovoj raportin vjetor të Punës së Auditorit të Brendshëm, për vitin 2017.
- Komisioni i Auditimit kërkoj nga shërbimet përkatëse që rekomandimet e dhëna nga Auditori i Brendshëm në raportet e prezantuara të implementohen me kohë.

Takimi i dytë i K.A është mbajtur me datë 26.02.2018, ku është diskutuar:

- Shqyrtimi i raportit të performancës operative dhe financiare të KRU Hidroregjioni Jugor për janar 2018,
- Raport nga zyra e Prokurimit për te gjitha aktivitetet ne vitin 2017 dhe plani operativ për vitin 2018 ,
- Prezantimi i kopjes se deklaratës se TVSH-s për janar 2018 .

Pas shqyrtimit të këtyre pikave Komisioni i Auditimit ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- Komisioni i Auditimit kërkoj që për takimin e radhës së Bordit të drejtorëve të paraqitet sqarim detal lidhur me rritjen e pagave dhe rritjen e shpenzimeve te mirëmbajtjes dhe riparimeve ne njësinë punuese te Prizrenit, si dhe të përgatiten listat sipas kategorive çka përfshihet te shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimeve dhe shpenzimet e tjera.
- Komisioni i Auditimit kërkoj nga Zyrtari i Prokurimit që aktivitetet e miratuara të prokurimit të paraqiten për çdo tre muaj në Komision të Auditimit gjatë tërë vitit 2018.

Takimi i tretë i K.A është mbajtur me datë 27.03.2018, ku gjatë këtij takimi është bërë:

- Shqyrtimi i raportit të performancës operative dhe financiare të KRU Hidroregjioni Jugor për shkurt 2018.
- Raporti i faljes së borxheve prej 12.10.2015 deri në 01.09.2017 sipas njësisë punuese.
- Shqyrtimi i pasqyrave financiare të Kompanisë për vitin 2017.

Pas shqyrtimit të këtyre pikave K.A ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- Komisioni i Auditimit kërkon nga Menaxheri rajonal për konsumator që për takimin e radhës të paraqitet raport për falje të borxhit i korigjuar me të dhëna të sakta nëpër tabela.

Takimi i katërt i K.A është mbajtur me datë 26.04.2018, ku gjatë këtij takimi është bërë:

- Shqyrtimi i raportit të performancës operative dhe financiare të KRU Hidroregjioni Jugor për TM1 2018.
- Raporti i faljes së borxheve prej 12.10.2015 deri në 01.09.2017 sipas njësisë punuese.
- Raporti nga Auditori i Brendshëm për TM1 2018

Pas shqyrtimit të këtyre pikave K.A ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- Komisioni i Auditimit kërkon që të shtohen përpjekjet nga shërbimet përkatëse të Kompanisë në realizimin e objektivave që dalin nga planifikimi i Planit të Biznesit, gjithsesi të shtohen përpjekjet të arkëtimit dhe të caku i ujit të pafaturuar sidomos në njësinë punuese të Dragashit dhe të Malishevës.
- Për të eliminuar dallimet në mes raporteve për falje të borxheve Komisioni i Auditimit rekomandoj Auditorin e Brendshëm dhe Menaxherin Rajonal për konsumator të krijojnë databazë në Excel sipas viteve duke filluar nga periudha 01.10.2015 deri 15.09.2017. Afati kohor për realizimin e këtij raporti është 01.06.2018
- Komisioni i Auditimit kërkon nga shërbimet përkatëse që rekomandimet e dhëna nga Auditori i Brendshëm në raportet e prezantuara për TM1-2018 të implementohen me kohë.

Takimi i pestë i K.A është mbajtur me datë 28.05.2018, ku është bërë:

- Shqyrtimi i raportit të performancës operative dhe financiare të KRU Hidroregjioni Jugor për prill 2018,
- Prezantimi i kopjes së deklaramentit të TVSH-s për muajin prill 2018.
- Shqyrtimi i raporteve nga Auditori i Brendshëm

Pas shqyrtimit është konkluduar dhe vendosur:

- Komisioni i Auditimit **miratoi** raportet e auditimit të paraqitura nga Auditori i Brendshëm dhe kërkoj nga shërbimet përkatëse që rekomandimet e dhëna nga Auditori i Brendshëm në raportet e prezantuara të implementohen me kohë.
- Komisioni i Auditimit pas shqyrtimit të bërë **miratoi** raportin e faljes së borxheve për vitin 2015-2017.

Takimi i gjashtë i K. është mbajtur me datë 27.07.2018, ku është bërë:

- Shqyrtimi i raportit të performancës operative dhe financiare të KRU Hidroregjioni Jugor për TM2 2018,
- Prezantimi i kopjes së deklaramentit të TVSH-s për muajin qershor-2018.
- Shqyrtimi i raportit për procedurat e iniciuara të Përmbaruesi për inkasimin e borxheve, periudha Janar-Qershor 2018 dhe inkasimet e realizuara për këtë periudhë.
- Shqyrtimi i raportit nga Komisioni për nivelizimin e pagave .

Pas shqyrtimit është konkluduar dhe vendosur:

- Komisioni i Auditimit pas analizimit të performancës operative dhe financiare të KRU Hidroregjioni Jugor për TM2 2018 jep vërejtje Njësive Punuese Malishevë, Suharekë dhe Dragash që të jenë më të kujdesshëm në raportimet e tyre ditore me shpenzimet operative dhe shpenzimet e tjera pasi që norma e arkëtimit gjatë TM2 2018 ka qenë nën nivelin e caqeve të parashikuara dhe në krahasim me TM1 2018.
- Komisioni i Auditimit kërkoj që të raportin të hyrave nga xhirollogaria përmes Përmbaruesit Privat të shtohet edhe shuma e borxhit të konsumatorit, kur është dërguar të Përmbaruesit Privat dhe borxhi i mbetur pas pagesave mujore. Njëherë Komisioni i Auditimit kërkoj që të dërgohet të Përmbaruesit Privat rastet e konsumatoreve nga të gjitha kategoritë që kanë borxhe të mëdha si dhe të jepet prioritet i veçantë rasteve që nuk i përmbahen kontratës që kanë nënshkruar me kompaninë për pagesën e ujit.

Takimi i shtatë i K.A është mbajtur me datë 28.09.2018, ku është bërë:

- Performanca operative e financiare gusht 2018,
- Raportet e auditorit për TM2 2018, Raporti final i auditimit, lidhur me menaxhimin e llogarive të pagueshme, Raport final lidhur me menaxhimin e procesit të intervenimeve dhe sajimit të defekteve në rrjet. Draft raporti i auditimit lidhur me menaxhimin e transportit në NjP në Prizren.
- Raporti i gjendjes të kontratave të faljes së borxheve sipas njësive punuese me shënimet nr. i konsumatorit, emri i konsumatorit, shuma e kontraktuar, shuma e paguar dhe mbetja e borxhit tani.
- Ndikimi i harmonizimit të pagave dhe ndikimet financiare.
- Deklarata për politiken e kompensimit për Drejtoret e bordit dhe zyrtarëve të lartë të KRU,, Hidroregjioni Jugor” Sh.A Prizren. Teksti i deklaratës të jete i njëjtë me deklaratën e datës 26.04.2017

Pas shqyrtimit është konkluduar dhe vendosur:

- Komisioni i Auditimit njëzëri **Aprovoj** Raportin e TM2 të Punës së Auditorit të Brendshëm, për vitin 2018.
- Komisioni i Auditimit pas aprovimit të bërë kërkoj nga Menaxhmenti i Kompanisë që të respektohen dhe implementohen të gjitha rekomandimet e dala nga Auditori i Brendshëm nëpër raportet e auditimit të bëra në TM2-2018.
- Komisioni i Auditimit rekomandon menaxhmentin e Kompanisë që përmes ekipeve të kontrollës, inkasantëve dhe ekipeve të operativës që të identifikoj konsumatorët që ju shkon vetëm fatura fikse.
- Komisioni i Auditimit pas shqyrtimit të bërë rekomandon Kryeshefin Ekzekutiv që rritjet e koeficienteve punëtorëve të Kompanisë dhe rritja sipas kërkesës së parashtruar nga Ujëinstaluesit të bëhet sipas mundësisë financiare të Kompanisë por mos të tejkalohet shuma e pagave e aprovuar nga ARRU për vitin 2018.
- Komisioni i Auditorit **Aprovoj** Deklaratën për politiken e Kompanizimit për Drejtorët e Bordit dhe Zyrtarët e KRU”Hidroregjionit Jugor “sh.a dhe të njëjtën propozon të aprovoj edhe Bordi i Drejtorëve.

-

- **Takimi i tetë i K.A njëherit edhe i fundit për vitin 2018 është mbajtur me datë 23.10.2018, ku është shqyrtuar:**

- Performanca operative e financiare shtator 2018,
- Raportet e Auditorit të Brendshëm për TM3 2018.
- Raporti i treguesve operativ dhe financiar për TM3 2018 dhe arritjet e caqeve.
- Raporti lidhur me kontrollin e bërë nga ATK-ja për vitet 2015-2017.

Pas shqyrtimit është konkluduar dhe vendosur:

- Komisioni i Auditimit pas shqyrtimit të raportit të muajit shtator 2018 konstatoj se performanca e Kompanisë është pozitive andaj e **aprovoj** raportin si të tillë

Komisioni i Auditimit njëzëri Aprovoj Raportin e TM3 të Punës së Auditorit të Brendshëm, për vitin 2018.

- Komisioni i Auditimit kërkoj nga departamentet dhe shërbimet përkatëse të Kompanisë të i adresojnë të gjeturat e Auditorit të Brendshëm dhe të i zgjidhin deri në një periudhë vijuese prej 6 muajve. Obligohet Auditori i brendshëm që pas 6 muajve të ripërsërit auditimet e përfshira në raportin e TM3.
- Komisioni i Auditimit pas shqyrtimit të bërë njëzëri **aprovoj** raportin financiar të Kompanisë për TM3- 2018 me sugjerimin që të shtohen përpjekjet për arritjen e caqeve të planifikuara për këtë vit kalendarik.

3. RAPORTI I ZYRTARIT KRYESOR EKZEKUTIV

3.1 NGJARJET KRYESORE TË VITIT

3.1.1 Aktivitetet nga Shërbimi Teknik – 2018



- * Takime ditore me Kryeshefin Ekzekutiv.
- * Vizite në punishte ne te gjitha projektet te cilat jane duke u implementuar.
- * Takime javore në Impiantin e Ujërave të Zeza.
- * Pergaditja dhe lidhja e Planeve per menaxhimin e thatesitave, planeve per furnizim me uje ne situata emergjente dhe strategjia per uljen e UPF-se, te njejtat jane dorezuar ne institucionet relevante si kopje te forta.
- * Takim me Kryetarin e Komunes se Prizrenit me agjenden:
 - Bartja e 11 parcelave te lokacioji i ITUZ-se ne emer te Komunes se Prizrenit,
 - Diskutimi i marrevshjes se vecant per projektin e ujerave te zeza, ku Komuna e Prizrenit eshte e obliguar te siguroj mjete shtese deri ne 2.5 milj. Euro,
 - Diskutimi per sigurimin e parcelave per Gypin Shkarkues nga ITUZ deri ne Lumbardh,
 - Diskutim per pagesen e mbetur tek Instituti Arkeologjik i Kosoves, per punet arkeologjike ne lokacionin e ITUZ-se.
- * Dalja dhe inspektimi i punimeve ne te gjitha projektet te cilat jane ne vijim dhe pritet te perfundojne gjate vitit 2018.
- * Takim i rregullt mujor me kontraktoret e fazes 2 dhe konsulencen, te projektit te ujerave te zeza ne Prizren, saktesisht projekti i ndertomit te ITUZ-se.
- * Takim me konsulencen e projektit Masat Shoqeruese.
- * Takim me perfaqesuesit e ARRU-se per mundesine e ndryshimit te tarifave, ku u dakorduam qe numri i stafit per ujera te zeza te rritet edhe per 2 punetor dhe shpenzimet per pagat e tyre te barten nga investimet kapitale me mjete vetanake.
- * Takim me KFOR-in-në lidhje me vazhdimin e bashkëpunimit në mes të KFOR-it dhe K.R.U "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, Prizren.
- * Takim me Drejtorin e Mirëqenies Sociale-në lidhje me mundësinë e investimit në hapjen e kanalit për instalimin e ujësjellësit (për banorët Social).
- * Takim me pronarët e parcelave - të cilëve ju atakohen pronat me trasen e gypit shkarkues të ITUZ-së.
- * Takim me Kryeshefin Ekzekutiv- Në lidhje me takimin që kemi pasur me banorët e fshatit Zhur për shpronësimin e tokave në te cilat do të ndërtohet gypi shkarkues i Impiantit të ujërave të zeza.
- * Takim i Komisionit i formuar nga Komuna e Prizrenit-në lidhje me pronat ku do të kalojë gypi shkarkues i ITUZ ku u vendos që të bëhet raporti përfundimtar dhe i njejtë të prezentohet pranë Kryetarit të Komunës si dhe u propozua që të bëhet një takim në mes të Kryetarit të Komunës, Kryeshefit ekzekutiv, K.R.U "HJ" dhe komisionit.
- * Pjesëmarrje në takimin me kompaninë DORSCH/CDI dhe Kryetarët e Komunave (Prizrenit, Suharekës, Dragashit)-për fazën e 6 të investimeve në zonat rurale (në restaurant "Sharr").
- * Takim me Vera Muhaxherin nga ARRU-në lidhje me caktimin e tarifave per kyçje dhe shërbime.
- * Vizitë- në punishte tek Lidhja e Prizrenit.
- * Takim me Delegacionin Japonez (ora 14:30)-të deleguar nga Ministria e Tokës, Infrastrukturës, Transportit dhe Turizmit të Japonisë për t'u informuar mbi gjendjen e ujërave të zeza dhe mbarëvajtjen e projektit të ITUZ-së.
- * Takim me Drejtorin e Shërbimeve Publike Levent Kasemi.

- * Takim me Kryetarin e Mamushës - përgjegje në dokumentin e dërguar nga Raif Preteni për furnizimin me ujë të pijshëm të Komunës së Mamushës.
- * Takim me Drejtorin e shërbimeve publike-për çështjen e gypit shkarkues të ITUZ-së
- * Takim javor tek Impianti (ora 14:00)- për Ujërat e Zeza.
- * Takim me zyrtaren për marrëdhënie me publikun Adelina Murtezaj Bajrami-në lidhje me kampanjën e komunikimit për Impiantin e ujërave të zeza.
- * Takim me Drejtorin e Ministrisë së Arsimit
- Dërgimi i dokumenteve tek KFOR-I
- Dërgimi i dokumenteve tek MMPH
- Dërgimi i dokumenteve tek JAPONIZËT
- Dërgimi i kërkesës për udhëheqës të njësisë Dragash
- Dërgimi i dokumenteve tek Ulrih-Konsulenca
- Dërgimi në ARRU i planit për menagjimin e thatësirave-i përmirësuar
- * Takim me nxënës të shkollave dhe vizitë në burimet e ujit-Te galeria dhe 40 burimet Prizren
- * Manifestim në Shtëpinë e Kulturës "Xhemajl Berisha" Prizren (ora 11:00-12:00), prezantimi lidhur me Ujin dhe Natyrën-Lumni Sallahu.
- * Shpërndarja e shpërblimeve për vizatimet dhe eset më të mira, me moton Uji dhe Natyra.
- * Trajnim një javor në Vienë, Austri - Për planin ndaj kujdesin e ujërave/Menagjimi i situatave të krizës (24.03.2018 - 31.03.2018).
- * Takim me Ministrin e Zhvillimit Ekonomik Valdrin Lluka.
- * Takim me Ulrihun.
- * Takim me ARRU-në.
- * Takim me Joerg (Konsulenca)/Prezantim: Statusi i projektit dhe vendimet e rekomanduara.
- * Takim i mëngjesit me K.Ekzekutiv-Claim nr.13 Aqualia.
- * Takim me Jeremy(Konsulenca)/Prezantim: Strategjia e llumit.
- * Takim në Prishtinë MMPH, Prezantimi i strategjisë së llumit.
- * Takim në Prishtinë - K.K.
- * Takim me Konsulencën dhe me udhëheqësin e zyrës për P.ZH z.Lumni Sallahu.
- * Takim zyrtar në Tiranë me kryetarin e Tiranës z.Erion Veliaj.
- * Takim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe banorët e fshatit Zhur.
- * Dërgimi i kërkesës për 8 punëtorë tek Enti për punësim.
- * Dërgimi i projekteve për Ujërat e Zeza në Qeverinë Japoneze.
- * Takim me Menaxhmentin lidhur me prezentimin e Impiantit tek Inkasantet dhe kontrolla.
- * Takim me Bordin.
- * Takim me Joergun dhe Simonin (Konsulenca).
- * Vizitë në Impiantin e Ujërave të Zeza – Niksiç / Mali i zi.
- * Takim me inspektoriatin e Prizren-it..
- * Trajnim në Konya – Turqi datë: 22.07.2018-29.07.2018.
- * Takim me Bob - p2m.
- * Takim me K.Ekzekutiv, Bob - p2m.
- * Takim i menaxhmentit Takim me Drejtorin e Shërbimeve Publike - Levent Kasemi.
- * Takim me Konsulencën - Diskutim rreth çështjes për vendosjen e gropës septike.
- * Takim me CDI-në.
- * Takim me Dorsch/Konsulenca
- * Takim me Konsulencën dhe menaxhmentin - Diskutim rreth tarifave.
- * Takim në Prishtinë-MZHE (10:00)
- * Takim me konsulencën (Joergun).
- * Takim me Konsulencën dhe me udhëheqësin e zyrës për P.ZH z.Lumni Sallahu. Me temën progresi i punimeve në projektin e ITUZ-së.
- * Takim me Konsulencën p2m dhe konsulencën Dorsch Group. Me temën progresi i punimeve në projektin e ITUZ-së.
- * Takim me Bob/Inxhinierin rezident të projektit - p2m-Konsulenca

- * Takim ne MMPH, me Ministrin Makolli, ku u diskutuan mudësitë e financimit te projektit për zonat e sigurisë të 40 Burimet dhe mundësine e mbeshtetjes finciare për TVSH-në e projektit të Ujërave të Zeza.
- * Takim ne MMPH, me Agim Radoniqin, ku u diskutuan plani per realizimin e projektit ne rrugen Janina.
- * Takim me Konsulencën P2m dhe Kontraktorin AQUALIA - Diskutim rreth menyrës së transportit të Llumit.
- * Takim me perfaqesuesit e larte te kontraktorit AQUALIA dhe Hidroterm, diskutim rreth progresit te ngadalshem te punimeve.
- * Takim me z Agim Radoniqi nga MMPH, per mundesine e kryerjes se obligimit prej 900.00 euro te mbetura nga fatura IPC nr. 11 te AQUALIA.
- * Korespondencat me KfW-ne me Elke Dulenkopf per kompletimin e dokumentacionit per pagesat ndaj kontraktoreve deri ne fund te vitit 2018. Dokumentacioni eshte kompletuar dhe eshte derguar per pagese ne KfW.
- * Takim me delegacionin e Bankes Gjermane per Zhvillim KfW, me Elke Dulenkopf dhe Uwe Aras, takim për progresin e punimeve në të gjitha projektet e financuara nga KfW.
- * Dalja në vendngjarje në fshatin Budakove për verifikimin e burimeve ujore në fshatin Budakove, prezent ishin perfaqesues të Autoritetit Rajonal te Pellgjeve Lumore ne MMPH, u kqyren burimet ujore dhe u perpilua proces verbali mbi kqyrjen e burimeve ujore nga ana e MMPH-se, mbetet te procedohet tek inspektoriati i MMH-së.
- * Dergimi i projekteve emergjente për financimin e mundshem nga teprica e buxhetit, kerkuar nga Fidaim Spahiu perfaqesues i NJPMNP pran MZHE-së.
- * Takim me mbikqyresen nga MMPH, kontraktorin DIAMANTI dhe stafin e Departamentit Teknik, për rojektin e rrugës Janina dhe Nëna Tereze, ku teme diskutimi ishte fillimi i punimeve për implemetimin e këtije projekti. Ne përcaktuam një mbikqyrës i cili do ti raportojë MMPH-së për zhvillimin e projektit.
- * Dalja në punishten e projektit të Gypit Shkarkues nga ITUZ deri në Lumbardh, projekti është duke u zhvilluar sipas dinamikës së dhënë në Planin dinamik, edhe përkundër pengesave nga banorët projekti është duke u zhvilluar si duhet.
- * Takim me konsulencen e Masave shoqeruese, për progresin e punimeve, dhe dakordimin e mënyrës së organizimit të kampanjës për sensibilizimin e konsumatoreve për projektin e ujërave të zeza në Prizren-ITUZ.
- * Përgaditja e Planit të Biznesit për vitin 2019, planifimimi i investimeve për vitet 2019-2021,
- * Dërgimi i dokumentacionit të kompletuar për aplikimin e lejeve ujore për burimet e reja të cilat në të ardhmen do të futen në përdorim për shkak të zgjerimit të zonës shërbyese në kuadër të KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh.A.
- * Vizitë në projektin e furnizimit me ujë për Komunën e Mamushës, projekti në fjalë është para finalizimit dhe deri në fund të muajit Nëntor do të finalizohet.
- * Vizitë në projektin e ndetimit të rezervoarit në rrugen e Novosejlanit, projekt i financuar nga komuna e Prizren-it, i cili do të mbulojë dhe ndajë fizikisht furnizimin me ujë për lagjen Dardania 1 dhe 2, si dhe pjesen e sipërme të lagjes Lurilla, ky projekt është në fazën finale dhe pritet të lëshohet në pune në fund të muajit Nëntor.
- * Dërgimi i projekteve në të gjitha agjencionet financuese të brendshme dhe të jashtme.
- * Skanimi dhe printimi i projekteve per Digene Manastirices dhe Dragaqines.
- * Takim në ARRU, me përfaqësuesit e ARRU-së për mundësine e ndërrimit të tarifave për vitin 2019, për shkak të i mpaktit që munde të ken shpenzimet e ITUZ-së për vitin 2019.
- * Takim me Konsulencën P2m dhe Kontraktorin AQUALIA - Diskutim per progresin e punimeve dhe permbajtjes se planit te ri dinamik te punimeve.
- * Korespondencat mbi kompletimin e dokumentacionit per Fazen 1 te punimeve, kolektorin kryesor ne anen e djathte te lumbardhit, ky kompletim ka te beje me pergaditjen e komplet dokumentacionit per fazen 1 ne menyre qe te munde te regjistrohesh si aset i kompanise.

- * Takim me perfaqesuesen e MMPH-se Myvedete Muja, per pergaditjen e dokumentacionit te duhur per mundesine e licensimit te burimit uxor ne fshatin Budakove.
- * Takim me mbikqyresen nga MMPH, kontraktorin DIAMANTI dhe stafin e Departamentit Teknik, per projektin e rruges Janina dhe Nena Tereze, ku teme diskutimi ishte finalizimi i projektit brenda vitit kalendarik 2018, ne i sqaruam disa pengesa nga banoret e lagjes, megjithate projekti eshte duke u zhvilluar sipas planit dinamik dhe deri ne periudhen raportuese kan perfunduar rreth 70% e punimeve.
- * Marrja e pelqimit ne Ministrine e Infrastruktures per depertimin e rruges N25 tek projekti Eflent Pipe, i cili i hap rruge kontraktorit qe te filloje punimet menjehere.
- * Takim me konsulencen e Masave shoqeruese, per progresin e punimeve, dhe dakordimin e vazhdimit te organizimit te kampanjes per senzibilizimin e konsumatoreve per projektin e ujerave te zeza ne Prizren-ITUZ.
- * Takim me perfaqesuesit e ARRU-se, per rishqyrtimin tarifar, ku u dakorduam qe te rishiqohet edhe njehere planbiznesi i miratuar qe eshte ende ne fuqi.
- * Takim me perfaqesuesit e Konsulences per fazen V, takimi ishte ne cilesine e takimit njoftues, ku ne si kompani i prezantuam te gjitha nevojat dhe dokumentacionet qe ne i posedojme dhe qe jane relevante per Fazen V te projektit.
- * Vizite ne Komunen e Mamushes per projektin e furnizimit me ujë për Komunen e Mamushës, projekti në fjalë është para finalizimit dhe momentalisht jemi ne fazen testuese te Rezervoareve, dhe planifikojme qe muajin dhjetor te perfundoj analiza e rrjetit dhe ne muajin janar.
- * Takim me delegacionin e Qeverise Gjermane, Ambasades Gjermane, GTZ-se dhe KfW-se, me temen progresi i projekteve te investuara nga qeveria Gjermane dhe progresi i tyre, u diskutua edhe per planifikimin e projekteve te cilat kan te bejne me paramarrevshjen financiare ne mes te Qeverise se Kosoves dhe Qeverise Gjermane kryesisht ne kemi ne e energjise se ripertitshme.
- * Takim ne ARRU, me perfaqesuesit e ARRU-së për mundësinë e ndërrimit të tarifave për vitin 2019, për shkak të i mpaktit që munde të ken shpenzimet e ITUZ-së për vitin 2019.
- * Takim ne objektet e KfW-se ne Prishtine shqyrtimin e minutave te takimit per Fazen V dhe VI te projektit te ujerave te zeza per qytetin e Prizrenit dhe qeshtjeve te tjera administrative dhe teknike qe kan te bejne me fazen V dhe fazen VI te projektit, takimi ishte mjaft i frytshem dhe propozimet tona u mirpriten nga delegaconi i KfW-se, ne si HRJ propozuam qe ta kemi nje konsulence per te dy fazat dhe ne aspektin teknik propozuam qe te kemi mundesi te furnizimit me nja kamion te madh me pompe shtytese dhe nje te vogel qe do tu pershtatet rrugeve te ngusa te qytetit, poashtu u dakorduam qe te furnizohemi edhe me nje CCTV-kamere per incizimin e rrjetit te kanalizimit.
- * Projektet e financuara nge Qeveria Zviceriane dhe projektit të Eficiences së Energjisë Elektrike të financuar nga KfW, raportet perkatese janë proceduar nga Menaxheret e ketyre projekteve Zenel Zenelaj dhe Aranit Ukimeri.
- * Sa i përket projektit te Ujerave te Zeza, konkretisht Fazes 1 dhe Fazes 2 te projektit, ju njoftoj se Faza 1 e projektit që ka të bëjë me Ndërtimin e kolektorit në anen e majtë të Lumbardhit, ka përfunduar komplet, tani jemi në fazën e përgaditjes përfundimtare të dokumentacionit të cilin do ta dorezojmë në arkive dhe në shërbimin për kontabilitet në menyre që të regjistrohet si aset i Kompanisë, kurse sa i përket Fazës 2 të projektit, tani me kemi hyre në fazën përfundimtare dhe sipas planit dinamik të rishikuar, punimet do të përfundojnë në Mars të vitit 2019. Për më tepër kemi në dispozicion Raportet Mujore dhe Tremujore si dhe për çdo gjë tjetër munde ta kontaktoni Kryetarin e Komitetit të këtijë projekti Lulzim Paçarizi dhe Anetarin e këtij komiteti Lumni Sallahun.

3.1.2 Aktivitetet nga Shërbimi Teknik për eliminimin e humbjeve teknike

-  Identifikimin dhe menjanimin e lidhjeve ilegale.
-  Rehabilitimin e rrjetit te vjeter te qytetit per eleminimin e humbjeve teknike – dedektimi i rrjetit te ujesjellesit dhe ndarja e zanave per dedektim.

- ✚ Senzibilizimin e te gjithë konsumatoreve per mos keqperdorim te ujit te pijes permes, fletpalosjeve, informatave mediale dhe atyre te shkruara.
- ✚ Ngritjen e vetedijes te te gjithë konsumatoreve qe ta paguajn ujin ne menyre qe te rritet inkasimi dhe te kemi mbulueshmeri financiare e cila do tu kthehet konsumatoreve ne sherbime dhe investime per sherbim sa me efikas te furnizimit me uje te pijes.

3.1.3 Planifiki i investimeve emergjente

(shiko planifikimin e investimeve)

3.1.4 Prodhimi i ujit m3

Prodhimi i ujit m3 - Janar-Dhjetor, 2018

Muaji	Prodhimi mujor m3	Prodhimi ditor- m3	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	12,803,162.00	35,077.16	406.0	
Suharekë	1,917,178.00	5,252.54	60.8	
Dragash	899,170.00	2,463.48	28.5	
Malishevë	1,418,782.00	3,887.07	45.0	
Total	17,038,292.00	46,680.25	540.3	

3.1.5 Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve

Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve / Janar-Dhjetor, 2018

Njësia Operative	Ujësjellësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	1,910	771	2,681
Suharekë	380	173	553
Dragash	60	25	85
Malishevë	569	171	740
Total	2,919	1,140	4,059

3.1.6 Zyra për planifikim dhe zhvillim – Janar - Dhjetor - 2018

Për periudhen qe po raportojme në kuader të zyres së Plan Zhvillimit grupet e organizuara të cilat veprojnë në teren kanë vazhduar bllobimet e ujëmatësave nëper qytetin e Prizren-it, ku kanë arritur këto rezultate:

- Kontrata dhe bllobime 3,050 kontrata.
- Konsumatorët që ekipa jonë nuk ka pasur qasje 5,906 konsumator.
- Ribllobim 3,587.
- Pa ujëmatës 728.
- Kerkesa nga konsumatorët 146.
- Regjistrim i ri 137.
- Lidhje uji jo 09.

- Duhet regjistruar 19
- Me puse / Pasivë 02.
- Ndrim të ujëmatësit 01.
- Zevendesim 208.
- Kerkesa nga konsumatorët D.M 03.
- Bllombime me kontrollën 06.

	Prizren Total –Gjithsej	Total
1	<i>Bllombim-Kontrata</i>	3,050
2	<i>Dera Mbyllur(Heren e dyte)</i>	5,906
3	<i>Pa ujëmatës</i>	728
4	<i>Ribllombim</i>	3,587
5	<i>Regjistrim i ri</i>	137
6	<i>Kerkesa nga Konsumatorët</i>	146
7	<i>Lidhje uji jo</i>	09
8	<i>Duhet regjistruar</i>	19
9	<i>Me puse / Pasivë</i>	02
10	<i>Ndrim të ujëmatësit</i>	01
11	<i>Zevendesime</i>	208
12	<i>Kerkesa nga konsumatorët</i>	03
13	<i>Bllombime me kontrollën</i>	06

AKTIVITETET KRYESORE

* Përpilimi i raportit Janar - Dhjetor , 2018.

* Mbikqyrja e projektit “Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në zonar rurale”, Prizren.

* Përpilimi, printimi dhe lidhja e planeve: Planit për thatesira, Plani për situata emergjente dhe Plani për humbje.

* Vizit në zyrat e ARRU-së në lidhje me planet: Planit për thatesira, Plani për situata emergjente dhe Plani për humbje si dhe njoftimi nga ana e ARRU-së që planet janë në shqyrtim.

* Nga data 06.02.2018 deri me 23.02.2018 është inspektuar rrjeti i kanalizimit në njësin e Suharekës, nga ekipa e inspektimit e caktuar nga njësia e Prizren-it.

Gjatë inspektimit të kanalizimit janë arritur këto rezultate: 501 Puseta të Inspektuara, ku prej këtyre pusetave janë identifikuar këto probleme

- 62 puseta për pastrim,
- 50 puseta ku nuk kemi pasur çasje,
- 18 defekte që dyshohen te jenë në rrjetin e ujësjellësit.

* Aktivitete dhe vizita për ditën botrore të ujit, vizita nga nxënësit e shkollave fillore në burimet e ujit si dhe organizime edukative-arsimore po për këtë ditë.

* Vizit nga PRU në Impijantin e pastrimit te ujërave të zeza në qytetin e Prizrenit si dhe organizim për shpërndarjen e fletushkave për ditën botërore të ujit.

* Takim pune në kshillin ndërministror zyra e kryeminisrit për Planin e investimeve afatgjate, pjesëmarrës të gjitha KRU-të e Kosovës takimi në objektin e qeverisë së Kosovës.

* Takim pune në kshillin ndërministror zyra e kryeminisrit për Planin e investimeve afatgjate, pjesëmarrës të gjitha KRU-të e Kosovës, takimi në KRU “Hidromorava” Gjilan.

* Takim pune në kshillin ndërministror zyra e kryeminisrit për Planin e investimeve afatgjate, pjesëmarrës të gjitha KRU-të e Kosovës, takimi në KRU “Hidrodrini” Peje.

* Takim me Vera Muhagjirin (ARRU) në Prishtine (F.Berisha dhe A.Spahiu).

* Takim në K.R.U “Gjakova” - Gjakovë për planin e Investimeve Afatgjata.

* Takim në K.R.U “Hidroregjioni Jugor” Sh.A - Prizren për planin e Investimeve Afatgjata.

* Fshati Smaç: 15 kontrata dhe bllombime, 20 pa ujematesa dhe 18 dera mbyllur.

- * Fshati Trepetic: 11 kontrata dhe bllombime, 16 pa ujematesa dhe 2 dera mbyllur.
- * Fshati Serbic e eperme: 4 kontrata dhe bllombime, 7 pa ujematesa, 6 nuk kane lidhje uji dhe 2 dera mbyllur.
- * Fshati Velezhë: 37 kontrata dhe bllombime, 45 pa ujematesa, 5 nuk kane lidhje uji, 7 me puse, 3 te pa banushme dhe 37 dera mbyllur.
- * Fshati Caparc: 23 kontrata dhe bllombime, 38 pa ujematesa, 43 me puse dhe 44 dera mbyllur.
- * Fshati Shpenadi: 27 kontrata dhe bllombime, 83 pa ujematesa dhe 55 dera mbyllur.
- * Grupi i demontim-montimit është angazhuar në fshatin Zojz për instalimin e ujëmatësave tek konsumatorët ku kanë bërë: 55 instalime të ujëmatësave si dhe 5 riparime të defekteve.
- * Takim pune në Prishtinë me CDI-në.
- * Takim pune në Prizren me CDI-në.
- * Takim në K.R.U “Prishtina” – Prishtinë për planin e Investimeve Afatgjata.
- * Koferenca e ujërave në Tiranë – Shqipëri.
- * Përpilimi i planit të Investimeve Afatgjata.
- * Mbikqyrje e punimëve në projektin e MMPH në rrugët “Janina” dhe “Nënë Tereza” – Prizren.
- * Mbikqyrje e projektit të CDI-së nëpër zonat rurale të Prizren-it.
- * Grupi i bllombimit është angazhuar në fshatrat: Lutogllav dhe Malsi e Re ku kanë arritur këto rezultate: 120 bllombime, 114 pa ujëmatës, 49 me puse, 04 të mbuluar me dhe, 06 shtëpi në ndërtim dhe 83 konsumator që ekipa jonë nuk ka pasur qasje.
- * Grupi i demontim-montimit është angazhuar në fshatin Medvec për instalimin e ujëmatësave tek konsumatorët ku kanë bërë: 39 vizita të konsumatorët si dhe 12 instalime të ujëmatësave.
- * Gjatë muajve Janar – Dhjetor grupi ka vazhduar me perpunimin e te dhenave te terrenit, vendosjen e te dhenave ne GIS.

MMS (Maintenance Management System) aplikacion i ndertuar nga ana e Sherbimit Teknik ne bashkepunim me Konsulencen eshte e gatshme per perdorim ku te gjitha kerkesat dhe ankesat merren apo kane nje direkt-lidhje (link) ku per secilen kerkese/ankese behet nje urdherese e punes ne forme digjitale i cili si aplikacion mundeson operimin dhe mirembajtjen me te lehte, gjenerimin e raporteve, numrin e oreve te puntoreve, numrin e oreve te makinerise se angazhuar e shume gjera te tjera ku do te egzistojte nje raport i vecante per kete.

Në këto muaj kemi filluar vendosjen (vizatimin) e kyqjeve shtepiake (ujësjellës dhe kanlizim) si dhe ujëmatësave në Gis ku për secilin layer do të vendosen të dhënat specifike si plotesimi i atributeve të nëvojshme si dhe vizatimi nga gypi kryesor deri tek ujëmatësi.

Gjithashtu është mbajtur një takim nga Sherbimi Teknik në lidhje për MMS ku secila njesi do të filloj që ta përdor këtë aplikacion për operimin dhe mirëmbajtjen e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Trajnimi eshte mbajtur ne zyret e Departamentit Teknik nga ana e Konsulences dhe Departamentit te Gis-it ku nga muaji i ardhshem do te fillojn qe ta perdorin kete aplikacion.

Databaza e konfiguruar nga ana e Sherbimit Teknik dhe MMS-Tool cdo dite behen backup dhe ruhen ne serverin e Kompanise dhe ne nje Hardisk te jashtem per rast sigurie.


Departamenti i Gis-it ka bërë lidhjen me serverin e faturimit (se bashku me kompanine e cila e menaxhon) ku kjo lidhje është direkte me tabelen billing_properties në kolonen blockmappingId ku tani e tutje çdo konsumatore i ri që do të regjistrohet do të plotesohet edhe kjo fushe, numer i cili do të merret nga Departamenti i Gis-it, gjithashtu edhe konsumatorët të cilet nuk janë lidhur me Faturimin janë duke u refreshuar dhe duke u plotesuar në kolonen blockmappingId.

Për refreshimin e konsumatoreve të cilet nuk janë lidhur me faturimin është krijuar një plan ku çdo inkasant në zonen të cilen ai punon vjen në mengjes në zyret e Departamentit Teknik dhe së bashku me operatorët e Gis-it vendosin lidhjen e konsumatorit në mes tabelës së faturimit me tabelen e konsumatoreve nga ana e Departamentit të Gis-it ku në këtë muaj janë përfunduar rreth 1000 konsumatore.

Ne vazhdim po i paraqesim disa karakteristika per rrjetin e kanalizimit (Numri i pusetave per secilen njesi):

STATISTIKA TE PERGJITHSHME TE KANALIZIMIT K.R.U "HRJ"SH.A, 2018

Nr	Qyteti	Nr Pusetave(n)	Gjatesia Gypave(km)	P(gjatesia e gypave)	P(pusetave)
1	Prizren	3731	118.8	77%	82%
2	Suhareke	573	24.5	16%	13%
3	Malisheve	222	7.4	5%	5%
4	Dragash	48	3.0	2%	1%
5	Mamushe	0	0	0%	0%
	TOTALI:	4574	153.7		



NR	LOCATION	No.MANHOLE
1	PZ	3903
2	SR	573
3	MA	222
4	DR	48
	TOTALI:	4746

Gjithashtu eshte vazhduar me matje me GPS ne qytetin e Prizren-it ku jane perfunduar 100% te matjeve ku tani konsiderojme qe te gjitha e dhenat per pusetat dhe gypat e kanalizimit jane marre. Këto të dhëna janë strukturuar në databazen e konfiguruar në serverin e kompanisë ku secilit përdorues të GIS-it ju është mundësuar qasja në databaze Postgis si dhe në hapësirën punuese QGIS, këto dy hapësira janë të nderlidhura mes vete gjë që ka mundësuar përfshirjen e shumë përdoruesve në të njejtën kohë.

* Kontrollimi i D.B, refreshimi i rekordeve në D.B, regjistrimi i rekordëve të reja në D.B, futja e të dhënave në D.B, përpunimi i të dhënave të grupit të kanalizimit në gjendje grafike (exel) nga terreni në Prizreni dhe fshatrat, punim në GIS – përpunimi i rekordeve të operativës gjatë kryrjes së defekteve, punë me MMS për operativen, gjetja e rekordeve në hartë me inkasantët, rregullimi i ujëmatësëve në GIS si dhe pregaditja dhe printimi i formularve për teren.

* Në muajt Janar - Dhjetor, grupi i terrenit demontim – montim me njësi në Prizren kanë arritur qe gjithsej të demontojnë dhe montojnë 1,166 ujëmatësë, ekziston raporti i veçant si dhe lexim të ujëmatësëve

* Grupi i detektimi të rrjetit të ujësjellësit gjatë muajve Janar - Dhjetor, ka bërë gjithësej 727 detektime, gjatë detektimit kanë hasur në 478 defekte, ekziston raporti i veçant. Po ashtu gjatësia e rrjetit të detektuar është 24,775 m.

* Leximi i ujëmatësëve zonal për muajin Janar - Dhjetor, ujëmatësat në pikat matëse: Të KFORI, Jusuf Gërvalla, të ETC-ja, Atmaxhë, Gorozhup kemi lexim të ulet të ujëmatësëve (ku Të KFORI vend i papërshtatshëm, të ETC-ja kemi bllokim të ujëmatësëve dhe Atmaxhë Baypass), Kojush II dhe Gjonaj i poshtem i kemi ujëmatësat e demtuar (xhami i ujëmatësëve dhe koka e ujëmatësëve), Plane, Shkoz, Vërmic rruga e bllokuar për shkak të borës, Kobaj, Nashec i epërm, Tupec dhe Grazhdanik i kemi pusetat me ujë, Vlashnje dhe Landovicë skemi lexim të ujëmatësëve. Pikat tjera janë nën monitorim dhe janë në gjendje të rregullt për këtë muaj.

* Poashtu në këto muaj kemi pasur dy rast për riparimin e ujëmatësëve që janë sjellë nga vet konsumatorët, ekziston raporti i veçant.

3.1.7 Shërbimi i mirëmbajtjes - Servisimi i ujëmatësave: Janar - Dhjetor - 2018

Ky shërbim bën servisimin dhe kalibrimin ujëmatësave të profileve $\Phi(13-100)$ mm.

Njësia Operative	Profili \emptyset mm	Sasia / copë	Vërejtje
Prizren	1/2"	337	
	3/4"	940	
	1"	84	
	5/4"	02	
	6/4"	02	
	Gjithsejt:	1365	
Suharekë	1/2"	00	
	3/4"	00	
	5/4"	00	
	Gjithsejt:	00	
Dragash	1/2"	16	
	3/4"	40	
	1"	03	
	Gjithsejt:	59	
Malishevë	1/2"	08	
	3/4"	77	
	1"	02	
	Gjithsejt:	87	

Totali: 1511 copa

Plus:

- Leximi i ujëmatësave 2 herë në muaj.
- 33 Ekspertiza

3.1.8 Raporti mbi cilësinë e ujit të pijes për Janar – Dhjetor 2018

Aktivitetet tjera :

- * Kontrolli permanent i klorit residual në të gjitha pikat e furnizimit
- * Kontrolli i burimeve dhe stacioneve të klorifikimit .
- * Marrja e MOSTRAVE në pikat sipas PLANIT të MONITRIMIT.
- * Furnizimi me kemikate që kanë munguar të "ERA-MED" Prishtinë.
- * Montuar pompat e reja për procesin e klorifikimit në stacionin e pompave "Bunar-1".
- * Të "Pusi I Atit " huazuar një injektor për "Bunar-1 " pastaj edhe e kthyem prap.
- * Furnizimi me Hipoklorur Natriumi fshatrat – Zhur, Kushnin e Kabash I Hasit.
- * Pas reshjeve të shiut erdhi të rritja e turbiditetit në burime të "40-Burimet" dhe për një kohë largam nga sistemi i furnizimit ujin e turbullt por futëm në funksion pompat.
- * Takim pune me inspektorin sanitar komunal Ruzhdi Hoxha.
- * Organizuar vizita të puntoreve për kontroll dhe paisje me librezë sanitare në ISHP.
- * Me kërkesë të drejtorit kemi qenë në fshatin Budakov dhe kemi marrë 5 MOSTRA për analizë bakteriologjike dhe fiziko-kimike.
- * Me kërkesë të drejtorit gjithashtu kemi marrë mostra edhe në fshatrat Greikoc dhe Mushtisht.

- * Ne KALA te qytetit ishin vendosur mbi REZERVUAR te ujit Kontenjer te nje ndertuesi qe punonte ne kala I terhoqem verejtjen dhe se bashku me zyrtarin per siguri te objekteve dhe inspektorin komunal I larguam kontenjeret nga vendi mbi Rezervuar.
- * Ne Kabash te hasit bem montimin e aparatit te klorifikimit ne objektin e ri .
- * Ne Samadrxhe ne stacionin e pompimit kemi mbajtur nje trajnim se si behet dozimi actual dhe menyra e matjes se klorit residual ne rrjet me aparatet e reja.
- * Ne Dragash ishim disa her ne lidhje me hapat qe duhet ndermar per sanimin e problemeve me te cilat ballafaqoheshin si papastrtia,pastrami ifiltrave,koagulatorit ne tersi si dhe ambienti per rreth.
- * Takim pune ne Prishtine ne hotel "AFA" me tem Kualiteti I ujit te pijes.
- * Ne Prishtine per tu furnizu me reagjent per laborator te " ERA-Med".
- * Ne Zhur ishim per te evituar defektin i cili pamundesonte procesin e klorifikimit.
- * Vizit nga nje delegacion prej zyres Zvicerane per te par paisjet e laboratorit dhe stafin qe punon me qellim qe te merren parasysh kerkesat tona per ndihme ne akreditim.
- * Riparimi i sistemit te klorifikimit ne fshatin Serbic e Ulet dhe marrja e mostres.
- * Riparimi i sisemit te klorifikimit ne "Bunar-1" disa pjes fazonike te injektorit .
- * Riparimi i sistemit te klorifikimit ne "Mullirin e vjeter" ne gypin e injektorit fi 600.
- * Po te "Mulliri i vjeter" bem nderrimin e injektorit ne fi 400 me injector te ri .
- * Ne Prishtin ne "Era-Med" u furnizuam me KOMPERATOR dhe me tablet DPD-1 .
- * Vizit pune ne Prishtine – SHUKOS .
- * Aktivizimi i aparateve te klorifikimit dhe furnizimi me klor ne tre fshatra qe jan marr ne menaxhim nga KRU" H,Jugor" ne ZOJZ,MEDVEC,NOVAK.
- * Riparimi i injektorit te Mulliri edhe pse gjat qershorit kemi ber zevendsimin e disa pjesev
- * Me 3.07.2018 dhe me dat.16.07.2018 pjesmarrja ne puntori nga SHUKO-s,Prishtine.
- * Me dat 16.08. 2018 pas reshjeve te medha qe ndodhen gjat ter nates dolem ne teren konkretisht se pari te BURIMET per te par si eshte gjendja me turbiditet konstatuam se gjendja eshte normale dhe se te reshurat nuk kan ndikuar ne rritjen e turbiditetit .
- * Ka ora 11 e 30 na njofton menaxheri i Suharekes z.Ismet Kurtishaj se gjendja ne cilesin e ujit eshte e rend per shkak te vershimeve te medhaja qe kan ndodhur ne ket teritor.
- * Me kete rast diskutuam me menagjerin per masat qe duhet ndermarr ne raste te tilla :
 - 1.Qe ne menyre permanente te behet klorifikimi i ujit ne Suharek pod he ne fshatrat dhe ate qe doza e klorit residual te shkoj edhe deri ne 0,6mg/l ne ujin e pijes.
 - 2.Te dezinfektohen puset dhe rezervuaret prej nga behet furnizimi i popullates me uje dhe te behet kontrolli p[ermanent derisa siuate te permisohet dhe te kthehet ne kushte normale.

Sygjeruam menaxherin e njesise ne Suhareke qe uji te mos perdoret per pije derisa te permisohet kualiteti dhe parametrat te sillen ne gjendje normale dhe te bej njoftim ne media se uji nuk ben te perdoret per pije.
- * U koordinuam me ekipin e Laboratorit te ISHP Prizren per marrjen e mostrave me qelim te kemi gjendjen e kualitetit te ujit nen kontroll ne te gjitha fshatrat e komunes se Suharekes te cilat jan vershuar nga te reshurat e medha qe ndodhen nje nat me par.
- * Se bashku me koleget e njesis nga Suhareka bem qe te aktivizohen sistemet e klorifikimit ne fshatrat : saqmadrazh,Semetisht,Reshtan,Studenqan,Doberdelan dhe ne fshatrat Sopi e Savrov .
- * Te " Pusi i atit" ishim per te sanuar problemet me te cilat ballafaqoheshim atje me procesin e klorifikimit.
- * Ne Prishtine ne "ERA-Med" u furnizuam me reagjent dhe paisje per pun ne laborator.
- * Takim pune ne Gjakov ne KRU "Gjakova"
- * Vizit ne shtepi private pas ankeses se konsumatorit per uje te turbullt ku konstatuam se problem qendron ne rrjetin e mbrendshem se eshte i vjetruar.
- * Kontroll ne fshatin LLADROVC pasi u informuam nga z,Ragip Limaj se dera e rezervuarit ishte thyer dhe dyshohet se mos eshte kontaminu uji per pije pasi jan par disa "tablata" ne afersi te rezervuarit,aty verejtem se behej fjal per(palin test)tablet DPD dhe Phenol Red te cilat I perdorim per te caktuar prezencen e klorit residual dhe mattjen e ambientit ne uje (a eshte acidic apo bazik).E kemi zbraz rezervuarin per shkaqe sigurie dhe e kemi mbushur me uje tjeter te paster.

- * Ne Prishtin ishëm ne puntorin e organizuar nga zyra Zvicrrane ne kuader te Programit mbeshtetes per Ujesjelles dhe Kanalizime ne zonat rurale.
- * Ne stacionin e klorifikimit ne "Bunar-1" bem riparimin e injektorit .
- * Ne stacionin e klorifikimit ne "Mulliri Vjeter " riparuar gypin e klorit te injektorit fi-600.
- * Serish ne stacionin e klorifikimit ne "Bunar-1" bem servisimin e ter sistemit te klorifikimit pas demeve qe na u shkaktuan nga amortizimi i disa pjeseve fazonike te cilat po na shkaktojn problem ne mbarvajtjen e procesit te klorifikimit.
- * Furnizimi i perhershem i fshatrave me Hipoklorur Natriumi(Uje zhaveli).
- * Defekte te medha prap te "Bunar-1" edhe ate ne gypin ku behet injektimi per ne rezervuarin e kalas te cilin e derguam te mjeshtri per ta riparuar.
- * Ne KRU "Gjakova" ishëm per trajnim mbi "MOSTRIMIN" si aktivitet i domosdoshem ne kuader te punes se laboratorit ghe pergaditjeve per akreditim te laboratorit te organizuar nga SHUKOS dhe IKSHP.
- * Me date 5.12.2018 ne takim te MMPH Afrim Laqi per Subjektet qe furnizohen nga resuset natyrore e qe duhet te kyqen ne system.
- * Me date 18.12.2018 takim ne Prishtin ne lidhje me problematiken e furnizimit me Klor .
- * Me rastin e problematikes se furnizimit me klor per shkak te takses 100% ndaj Serbis eshte veshtersuar furnizimi dhe ne kemi kontaktuar me kontraktorin dhe na eshte premtu se nuk do te kemi problem te furnizimit por na eshte then se do te ndryshon qmimi por per kete e kemi njoftuar se duhet te merret vesh me zyren e Prokurimit.
- * Kshtu tani jemi te furnizuar me Klor gas dhe Hipoklorur natriumi edhe per periudhen dy mujore me shpres se pas kesaj kohe do vazhdojm te mos kemi problem.

VEREJTJE :

Gjatë këtij muaji kemi pasur probleme të mëdha me AUTOMJET.

Analizat Bakteriologjike Laboratori "Hidroregjioni Jugor " Prizren, Janar - Dhjetor - 2018

Njesia	Lloji i ujit	Nr.i mostrave	Nr.i Mostrave qe nuk pergjigjen
Prizren	Burim	38	0
	Ujesjelles	187	3
Suhareke	Burim	2	0
	Ujesjelles	58	12
Dragash	Burim	12	0
	Ujesjelles	26	0
Malisheve	Burim	1	0
	Ujesjelles	31	4
Totali		355	19

Analizat Bakteriologjike, ISHP - Prizren Janar - Dhjetor/2018

Analizat Bakteriologjike Janar - Dhjetor 2017, ISHP-Prizren

Njësia	Nr.i mostrave	Përgjigjen	Nuk përgjigjen
Prizren	754	754	0
Suharekë	96	96	0
Dragash	40	40	0
Malishevë	95	95	0
Totali	985	985	00

Analizat Bakteriologjike Janar - Dhjetor 2018, ISHP-Prizren

Njësia	Nr.i mostrave	Përgjigjen	Nuk përgjigjen
Prizren	825	824	01
Suharekë	111	109	02
Dragash	46	45	01
Malishevë	108	108	00
Totali	1.090	1.086	04

Numrin total i analizave në ujësjellës 1,090 nga to 1.086 apo 99.63% i përgjigjen standarteve ndersa vetem 4 nuk i përgjigjet standardeve. (0.37%)

*analizat e ujit të burimeve nuk mirren në konsideratë.Uji i patrajtuar.

Vrejtje: Numri i analizave të mostrave bakteriologjike të marrura në rrjetin e ujësjellësit është 985 nga këto të gjitha i përgjigjen.

PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

- Keqpërdorimi i ujit të pijes.
- Ndërprerja e herë pas herëshme e energjisë elektrike.
- Shpenzimet e mëdha të energjisë elektrike.

MASAT E REALIZUARA / MOS REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Te gjitha defektet ne sistem te ujesjellesit dhe kanalizimit jane sanuar me kohe,
- Eshte percjell ne menyre permanente cilesia e ujit te pijes ne nivel regjional,
- Eshte pergaditur dhe miratuar strategjia e UPF-se.

MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM

- Monitorimi i furnizimit me uje te pijes ne gjith zonen e sherbimit,
- Monitorimi i cilesise se ujit te pijes ne nivel regjional,
- Vazhdimi i analizes se rrejtit te ujesjellesit dhe bartja e te dhenave ne GIS,

-Fillimi i implementimit te strategjise per uljen e UPF-se.

-Aktivitet e shërbimit teknik të ndermarrur për eliminimin e humbjeve teknike.

- ✚ Identifikimin dhe menjanimin e lidhjeve ilegale.
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit te vjeter te qytetit per eleminimin e hubmjeve teknike – dedektimi i rrjetit te ujesjellesit dhe ndarja e zanave per dedektim.
- ✚ Senzibilizimin e te gjithë konsumatoreve per mos keqperdorim te ujit te pijes permes, fletpalosjeve, informatave mediale dhe atyre te shkruara.
- ✚ Ngritjen e vetedijes te te gjithë konsumatoreve qe ta paguajn ujin ne menyre qe te rritet inkasimi dhe te kemi mbulueshmeri financiare e cila do tu kthehet konsumatoreve ne sherbime dhe investime per sherbim sa me efikas te furnizimit me uje te pijes.

3.2. AKTIVITETET NGA SHËRBIMI RAJONAL PËR KONSUMATORË

3.2.1 Aktivitetet kryesore

- Është bërë leximi i ujëmatësve nga inkasantët (lexuesit) e terrenit .
- Janë shtyp dhe shpërnda faturat e shërbimeve të ujësjellsit mbrenda afatit ligjor te secili konsumatorë.
- Janë shtyp 2594 fatura më tepër si rezultat i rritjes së konsumatorëve në zonën e shërbimit .
- Janë vizituar nga inkasantët të gjithë konsumatorët në pronat e tyre ku janë shpërnda faturat dhe është kërkuar inkasimi i mjeteve për shërbimet e ujësjellsit .
- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike dhe komerciale të konsumatorëve

3.2.2 RAPORTIMI EKIPES SË KONTROLLES DHE SHKYÇJES JANAR- DHJETOR – 2018

- Janë vizituar nga ekipet e kontrollës konsumatorët për mospagesë të shërbimeve të ujësjellsit, të cilët nuk paguajn faturat dhe atyre që kanë borxhe të mëdha ndaj KRU “ Hidroregjioni Jugor” sha. Secilit konsumatorë të vizituar nga ekipet e kontrollës i është lënë procesverbali ku ceket borxhi dhe afati për pagesën e borxhit.
- Janë bërë kontrolle në teren te konsumatorët nga ekipet e kontrollës edhe për shqyrtim të ankesave të konsumatorëve dhe regjistrime të konsumatorëve të rinj.

2017

Njesia Operative	Lidhjet e reja	Ç'kyçjet	Lidhje ilegale	Proceverbale	Verifikimi i ujëmatësve	Inkasimi nga kontrolla
Prizren	1,217	79	73	6,369	5,998	23,829.16
Suharekë	188	63	45	2,632	5,247	9,725.55
Malishevë	193	11	8	593	1,423	0
Dragash	3	-	-	-	10	0
KRU. HJ	1,601	153	126	9,594	12,678	33,554.71

2018

Njesia Operative	Lidhjet e reja/legalizime	Shkyçjet	Lidhje jasht orës	Vërejtje për borxhe/përmbarrim	Verifikimi i ujëmatësve
Prizren	1,711	93	90	12,778	3,233
Suharekë	262	29	31	1,766	4,715
Malishevë	430	41	23	2,129	2,195
Dragash	6	0	0	52	18
KRU. HJ	2,409	163	144	16,725	10,161

3.2.3 RAPORTI I ANKESAVE

JANAR- DHJETOR – 2018

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	1,882
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	1,882
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	944
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	944
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	944

Koment:

Të gjitha ankesat janë shqyrtuar me kohë. Konsumatorët kanë marrë përgjigje zyrtare nga kompania.

Një numër i konsideruar i ankesave është konstatuar se kanë qenë të babazuara.

Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe

- Vazhdon mos zgjidhja e problemit të rasteve sociale, kjo kategori e konsumatorëve po ndikon në mungesën e inkasimit të kësaj kategori e konsumatorëve.
- Pamundësia e leximit të ujëmatsve për çdo muaj të një numër i konsumatorëve, nga inkasantët tek shtëpit (pronat) e konsumatorëve, pasi në kohën kur bëhet leximi nuk gjenden në shtëpi apo edhe nuk i hapin dyert për t'iu mundësuar inkasantëve leximin e orëve (kryesisht të konsumatorët që jetojnë në ndërtesa kolektive-banesa).
- Moszgjidhja e qeshtjes së borxheve të meherëshme, trashëgimi i borxheve në pronat e konsumatorëve
- Problemet e vazhdueshme me softver nga pamundësia e gjenerimit të raporteve sipas kërkesave tona.
- Faturat e mëdha mujore të disa konsumatorëve si rezultat i rrjedhjeve mbrenda ujëmatësit dhe pamundësia e pagesës së tyre
- Moszgjidhja e problemit të borxhit për shpenzimet e ujit mes shitësit dhe blerësit të pronës, pronave të uzurpura që nga pas lufta, pronat që kanë qenë nën administrimin e Agjencionit Kosovar të Pronës.

Masat e realizuara/ mosrealizuara nga periudha paraprake

- Rritje të numrit të konsumatorëve në zonën e shërbimit si rezultat i legalizimit të konsumatorëve ilegal apo edhe pëlqimeve për kyqje.
- Rënie e faturimit në m³ si rezultat i kushteve atmosferike (verës me rënie të shiut të bollshëm)
- Rritje e inkasimit si rezultat i rritjes së aktiviteteve të Shërbimit me Konsumatorë dhe Shërbimeve tjera.

Masat e propozuara për periudhën në vazhdim

- Vazhdimësi e thirrjeve me telefon dhe dërgimi i mesazheve përmes telefonit te konsumatorët të cilët nuk i përmbahen kontratës.
- Dërgimi i vërejtjeve për ndërprerje të shërbimit te konsumatorët pa ujëmatës.
- Trajtimi i një numri më të madh të konsumatorëve në teren, shpërndarja e paralajmërimeve para inicimit të rasteve te përmbauresi duke i ndërruar terrenet e inkasantëve.
- Vizita më të shpeshta te konsumatorët e bizneseve të cilët kanë borxhe, ata të cilët kanë bërë kontratë e të cilët nuk i përmbahen pagesës së kisteve.
- Vazhdimësia e mbeshtetjes së inkasantëve nga ekipi i kontrolles te konsumatorët të cilët në vijimësi nuk paguajn faturat
- Mbikqyrja dhe monitorim i vazhdueshëm i inkasantëve në arritjen e limitive në inkasim
- Regjistrimi i vazhdueshëm i konsumatorëve që dëshirojnë të kyqen në shërbime të ujësjellsit dhe kanalizimit.

3.3 AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

3.3.1 ktivitetet kryesore

Hyrje

Departamenti Administrativ është një nga Departamentet që ka përgjegjësi të drejtpërdrejt tek Kryeshefi Ekzekutiv. Në kuadër të Departamentit Administrativ sipas strukturës organizative të Kompanisë, bëjnë pjesë këto sektorë: sektori i administratës së përgjithshme dhe resurseve njerëzore, zyra ligjore, IT, zyrtari për sigurinë dhe shëndetin në punë, Shefi i Sigurimit Fizik të Objekteve dhe Administrator i Rojës mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve.

Aktivitetet e përbashkëta të punës në Departamentin administratës:

Departamenti i administratës gjatë këtij viti është marr me përgatitjen e raporteve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

Në kuadër të raportit të Departamentit Administrativ sipas strukturës organizative të Kompanisë janë përfshirë edhe raportet e sektorëve të departamentit të administratës si raporti i punës së zyrës ligjore, i resurseve njerëzore, zyrtarit për siguri dhe shëndet në punë, aktivitetet e Shefit të Sigurimit Fizik të Objekteve dhe Administrator i Rojës dhe raporti i punës së zyrës së teknologjisë informative për janar - dhjetor 2018.

- Gjatë këtij viti janë përgatitur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dala nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit, komiteti i financave, komiteti për staf dhe shpërblime dhe Kryeshefi Ekzekutiv i KRU "Hidroegjioni Jugor" sh.a Prizren . Për Vendimet dhe Rekomandimet e dala në takimet e BtD dhe Komisionit të Auditimit janë njoftuar të gjithë zyrtarët dhe udhëheqësit e Kompanisë pas përfundimit të procesverbalit të takimit përkatës.
- Nga zyra ligjore gjatë vitit 2018 është bërë përfaqësimi i Kompanisë në Gjykatën Themelore të Prizrenit, Dragashit, Malishevës dhe Suharekës si dhe është punuar intensivisht në procedimin e lëndëve të përmbaresit privatë për secilën njësi punuese, lëndë këto që kanë të bëjnë me konsumatorët e amvisërisë dhe bizneset që kanë borxh ndaj shërbimeve të ujësjellësit.
- Janë harmonizuar kontratat e punës për punëtorët e Kompanisë sipas Rregullores mbi organizimin dhe sistematizimin e punëtorëve në punë dhe detyra të punës.
- Gjatë vitit 2018 janë përgatitur dhe vazhduar kontratat e punës që kanë qenë në kohë të caktuar për punëtorët e Kompanisë. Kohëzgjatja e kontratave është bërë duke u bazuar në raportin e vlerësimit vjetor të punës së secilit punonjës, raporti i vlerësimit i bërë nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i punëtorit.
- Aktvendimet për pushime vjetore janë lëshuar pas kërkesës me shkrim të punëtorëve dhe aprovimit apo pëlqimit nga udhëheqësit e tyre.
- Në mbështetje të nenit 56 të Ligjit të punës Nr. 03/L-212 , për punonjësit e Kompanisë është bërë kompensimi i punës jashtë orarit me ditë pushimi dhe përqindje të pagesës sipas ligjit në fjalë.

- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendeve të punës me pëlqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- Nga udhëheqësit e departamenteve dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të shërbimeve përkatëse të Kompanisë është bërë vlerësimi vjetor i performancës së secilit punonjës për kryerjen e detyrave të punës në Kompani gjatë vitit 2018.
- Gjatë vitit 2018 janë pensionuar 6 (gjashtë) punëtor K.R.U. "Hidroregjioni jugor" Sh.A Prizren,
- Gjatë vitit 2018 kanë shfrytëzuar pushimin mjekësor 80 punëtorë të Kompanisë.
- Në Departament të Administratës kemi pasur auditim nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2018.
- Në Departament të Administratës kemi pasur auditim nga Auditori i Brendshëm, lënda e auditimit ka qenë lidhur me menaxhimin e procesit të rekrutimit të punonjësve, në KRU "Hidroregjioni Jugor" SH. A në Prizren, i zhvilluar gjatë periudhës kohore 01.07.2017 deri më 31.03.2018.
- Është bërë mbikëqyrje dhe mirëmbajtje e duhur në azhurnimin e rregullt të ueb-faqes, siç parashihet me Ligj mbi NP, janë kryer të gjitha arkivimet, publikimet për autoritetin përkatës sipas ligjit.
- Me autorizim të KE janë përgatitur Vendime për mbikëqyrje të punimeve dhe pranim teknik të punimeve për projektet e investuara me mjetet vetanake të Kompanisë dhe nga buxheti i Komunave të njësive punuese sipas kërkesës së shërbimit teknik.
- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga lamia e veprimtarisë së Kompanisë.
- Sipas kërkesave menaxherëve të Kompanisë dhe të udhëheqësve të njësive punuese Prizren, Suharekë dhe Malishevë dhe pas aprovimit nga Zyrtar Kryesor Financiar("ZKF") dhe Kryeshefi Ekzekutiv në shtypin ditor janë shpallur **15** konkurse. Prej këtyre konkurseve nëntë janë anuluar, dhe pesë konkurse janë rishpallur .
- Me Vendim janë formuar Komisionet për regjistrim vjetor 2018 që përfshin: Komisioni për regjistrimin e mjeteve themelore, veglave të rënda dhe inventarit të imët; Komisioni për regjistrimin e lëndëve të para dhe materialit në depon kryesore dhe në servis të bazhdarimit; Komisioni për regjistrimin e arkës, porto-arkën, kërkuetit dhe blerësit dhe Komisionin Qendror të regjistrimit. Të gjithë komisionet e regjistrimit do të kryejnë regjistrimin prej 29.12.2018 gjerë më 15.01.2019 dhe në fund do të kryhet barazimi me gjendjen e kontabilitetit dhe raporti do të i dorëzohet komisionit qendror. Komisioni qendror është i obliguar të përpiloj raport mbi kryerjen e të njëjtës dhe t'ia dorëzoj Kryeshefit Ekzekutiv gjerë më 20.01.2019.
- Në bazë të nenit 2. paragrafi 1. të Ligjit Nr. 2003/19 për sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës dhe të nenit 5. paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në punë, Punëtorit H. J i sistemuar në punët dhe detyrat e punës Përgjegjës i përpunimit dhe kontrollit të kualitetit të ujit, në njësinë e Suharekës, i është bërë pagesa e shpenzimeve të mjekimit nga lëndimi në vendin e punës.
- Në bazë të nenit 7. pika 2. Statutit të K.R.U"Hydroregjioni jugor"Sh.A me seli në Prizren, janë përpiluar dhe aprovuar këto rregullore të Kompanisë:
- **Strategjinë për Zvogëlimin e Humbjeve të Ujit për 2018 – 2022 në KRU"Hydroregjioni Jugor"Sh. A, Prizren.**
- **Rregulloren e brendshme për menaxhim të aseteve të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hydroregjioni Jugor"Sh. A.- Prizren.**
- **Udhëzuesin për menaxhimin e borxheve në sektorin e shërbimeve të ujit me politikën dhe procedurat për menaxhimin e borxheve të KRU"Hydroregjioni Jugor"Sh.A Prizren".**
- **Planin afatgjatë të investimeve për 2019-2028" në KRU"Hydroregjioni Jugor" SH.A Prizren.**
- Është përgatitur Libri lidhës për Qeverisjen Korporatave për vitin 2017 dhe dorëzuar në NJPMNP, përmbajtja e saj përfshinë : Certifikatën e regjistrimit të Biznesit,Vendimin mbi emërimin e Bordit, procesverbalet e mbledhjeve të Bordit për vitin 2017, Vendimet e Bordit

për 2017, Procesverbalet e Komisionit të Auditimit, Deklarata e politikës së kompensimit, Vendimet mbi themelimin e komiteteve tjera të Bordit, Procesverbalet e komiteteve, Plan-Biznesi 2017-2019 dhe raporti vjetor 2017.

- Përgatitja e Aktvendimeve për pushim pa pagesë për disa punëtor të Kompanisë pas aprovimit të kërkesës së tyre nga udhëheqësi i shërbimit përkatës.
- Përgatitja e Aktvendimeve për disa punëtor lidhur me kompensimin e punës jashtë orarit me ditë pushimi sipas Ligjit të Punës.
- Gjithashtu ky shërbim lëshon për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.
- Gjatë viti 2018 kanë ndërprerë marrëdhënien e punës me vetdëshirë 4 punëtor të Kompanisë.
- I është shqiptuar masa disiplinore Vërejtje me shkrim të punësuarit Z. J i sistemuar në punë dhe detyra të punës Kujdestar-rojtar te bunari 1, në njësinë punuese të Prizrenit , për shkak të shkeljes së detyrave të punës.
- Pas inicimit të procedurës disiplinore ndaj punonjësit Rojtar-kujdestar në stacionin e pompave në Banjë në njësinë e Malishevës M. Sh, për shkak të shkeljeve të detyrave të punës të parapara në nenin 5 të Rregullores së Kompanisë i është shqiptuar masa disiplinore Vërejtje me shkrim.
- Nga ARRU është përtërirë licenca për shërbime e KRU" Hidroregjioni Jugor" sh.a Prizren me datë të lëshimit 25.09.2018 dhe data e skadimit 10.09.2026.
- Është dërguar prapë kërkesa për riorganizim të NP- KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh. A në Prizren dhe KRU" Gjakovë" Sh. A në Gjakovë dhe është drejtuar ne MZHE dhe MMPH ende nuk kemi përgjigje nga Ministritë në fjalë.
- Është dërguar në NJPMNP sipas kërkesë Lista me të dhënat e kohëzgjatjes së kontratave të punës për zyrtarët e lartë të kompanisë.
- Është raportuar në NJPMNP numri i punonjësve të Kompanisë me aftësi të kufizuar për vitin 2017.
- Janë dërguar në NJPMNP Përgjigjet në pyetjet e kërkuara nga Drejtori i NJPMNP shtesë, te cilat kanë të bëjnë me projektin e Komisionit Evropian "Projekti i Vlerësimit të Rreziqeve në Qeverisje në Ballkanin Perëndimor – GRASP".
- Sipas kërkesës së NJPMNP është raportuar për kompensimet mujore dhe vjetore për vitin 2017 të Bordit të Drejtorëve dhe për pagat e zyrtarëve të lartë të Kompanisë gjithsej për vitin 2017.
- Pas kërkesës për vazhdim të bashkëpunimit në projektin e punësimit të rinjve të bërë nga Kompania jonë, është nënshkruar Marrëveshje e bashkëpunimit për praktikë në punë të punëkërkesve në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe KRU" Hidroregjioni Jugor". Marrëveshja do të fillojë se zbatuari me datë 01 Mars dhe do të zgjasë deri me 31 Gusht 2018. MPMS punëtorët e angazhuar do të paguaj me pagë mujore në shumën prej 250 euro në muaj dhe KRU"HRJ" do të bashkëfinancoi projektin duke siguruar mjetet e punës për punëtor si dhe shujtat ditore në vlerë prej 2.5 euro në ditë.
- Nga muaji Dhjetor janë angazhuar me kontratë në kohë të caktuar praktikant në punë praktike ashtu siç është paraparë ne Marrëveshjen e bashkëpunimit për praktikë në punë të punëkërkesve në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenës Sociale dhe KRU" Hidroregjioni Jugor". Kjo marrëveshje ka filluar të zbatohet nga data 03 dhjetor dhe do të zgjasë deri me 03 Qershor 2019. MPMS punëtorët e angazhuar do të paguaj me pagë mujore në shumën prej 250 euro në muaj dhe KRU"HRJ" do të bashkëfinancoi projektin duke siguruar mjetet e punës për punëtor si dhe shujtat ditore në vlerë prej 2.5 euro në ditë.
- Nga Drejtoria e shërbimeve publike ne Komunën e Prizrenit kemi kërkuar lejimin e hulumtimit të ujit të pijes në parcelën e njësisë kadastrale P-71813061-00054-0 pronë shoqërore e zonës kadastrale ne Novakë- Komuna e Prizrenit. Kërkesa është aprovuar nga Drejtoria në fjalë.
- Takim pune me përfaqësuesit e Spitalit të Prizrenit lidhur me kyçjen e spitalit në rrjet të ujësjellësit të KRU"HRJ pas reagimit të dërguar ne spital nga ARRU-ja.

- Pjesëmarrje ne trajnim me teme Komunikimi dhe marrëdhënia me publikun”, “Rëndësia dhe mekanizmat e komunikimit të brendshëm dhe atij te jashtëm “dhe “Marrëdhëniet me media , media sociale dhe menaxhimi i krizave”.
- Pjesëmarrje në punëtorinë për Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, punëtorja është organizuar nga Agjencia kundër korrupsionit për Ndërmarrjet Publike. Qëllimi parësor i këtij Ligji është forcimi i integritetit të sektorit publik dhe garantimi i kryerjes së detyrave publike në meny objektive, të paanshme dhe transparente.

3.3.2 Personeli

PERSONELI – JANAR– MARS 2018

Muajt	Nr. i te punësuarve sipas muajve	Vende te plotësuar	Te larguar	Të pensionuar	Punë praktike
Janar	327				1
Shkurt	327				1
Mars	326	1	1	1	

Prill	323		2	1	
Maj	322				
Qershor	322			1	

Korrik	324	2			
Gusht	327	3	1	3	
Shtator	322		2	1	

Tetor	323				
Nentor	323				
Dhjetor	324	1			

3.3.3 KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: DHJETOR 2018

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A								
DHJETOR	KUALIFIKIMI							
	Fakultet	Bachelor	Sk.K. e lartë	Sh. e mesme	Sh.N.E	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsejtë
Nr. i punëtorëve	33	38	1	205		46	1	324
Kualifikimi në %	10.19	11.73	0.31	63.27	0.00	14.20	0.31	100

3.3.4 NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: DHJETOR- 2018

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Mysliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	279	33	5	7	324
Numri i Punëtorëve në %	86,1	10,2	1,5	2,2	100

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	40	12,35	
MESHKUJ:	284	87,65	
TOTAL	324	100,00	

Çdo kërkesë për punonjës të ri në Kompani është bazuar në planifikimet dhe kërkesat me arsyeshmeri të Menaxherëve të Departamenteve dhe udhëheqësve të njësive operative të Prizrenit ,Suharekës, Malishevës dhe Dragashit.

Arsyeshmëria e punësimit të punonjësve të ri gjatë vitit 2018 është me qëllim që të kemi menaxhim dhe një mbikëqyrje e punimeve në nivel profesional në zona të reja të shërbimit. Numri i punëtorëve është planifikuar duke u marrë parasysh: formimi i ekipeve të veçanta për mirëmbajtjen dhe analizën e sistemit ekzistues të kanalizimit-Ujërave të zeza në qytetin e Prizrenit, zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në zonat rurale sipas projektit të zyrës Zvicerane, rritja e numrit të konsumatorëve si dhe duke u bazuar në rritjen e aktiviteteve dhe efikasitetin të punës në Kompani.

Gjatë planifikimit të vendeve të punës dhe themelimit të marrëdhënies së punës është respektuar Ligji i Punës, Ligji i Ndërmarrjeve Publike dhe Kodi i Etikës dhe se Kompania nuk bënë asnjë dallim apo diskriminim në organizimin apo caktimin e obligimeve të punës në të gjitha shërbimet.

3.3.5 RAPORTI VJETOR NGA ZYRA LIGJORE E KOMPANISË

PËRFAQËSIMI NË GJYKATA DHE ARDHJA TOTALE E LËNDËVE NGA GJYKATAT PËR PERIUdhËN KOHORE JANAR – DHJETOR 2018 SEANCAT GJYQËSORE

Muaji	Seanca përgatitore	Seanca kryesore	Seanca të shtyra	Shkresat e ardhura nga gjykatat
Janar	3	/	/	16
Shkurt	/	1	1	10
Mars	3	1	/	14
Prill	3	2	1	12
Maj	4	4	3	15
Qershor	/	2	1	7
Korrik	/	/	1	28
Gusht	/	/	/	14
Shtator	1	/	/	16
Tetor	2	2	/	9
Nëntor	5	/	/	109
Dhjetor	3	/	/	70
Totali	24	12	7	320

Siç edhe shihet në tabelën lart, në këtë periudhë kohore kemi marrë pjesë në gjithsej **320 (treqindtë e njëzet)** seanca gjyqësore prej të cilave **24 (njëzet e katër)** seanca kanë qenë përgatitore, **12 (dymbëdhjetë)** seanca kryesore dhe **7 (shtatë)** seanca për arsye objektive janë shtyrë dhe do të caktohen data të tjera për shqyrtim.

Gjatë vitit 2018, në Zyrën Ligjore nga Gjykatat kanë ardhur këto shkresa:

- **3 (tri)** Aktgjykim në favor të Kompanisë;
- **1 (një)** Aktgjykim kundër Kompanisë;
- **Për 17 (shtatëmbëdhjetë)** lëndë nga gjykatat janë marrë Aktvendime në favor të kompanisë;
- **Për 13 (trembëdhjetë)** lëndë nga gjykatat janë marrë Aktvendime kundër kompanisë;
- **Për 27 (njëzet e shtatë)** lëndë gjykatat kanë aprovuar pjesërisht Prapësimet e konsumatorëve;
- **3 (tri)** Konkluzion me të cilin gjykata na njofton se pala në procedurë ka vdekur;
- **4 (katër)** Konkluzione me të cilat gjykata cakton përfaqësues të përkohshëm pasi që pala ka vdekur;
- **Nuk ka pasur** Konkluzione;

- **Nuk ka pasur** Njoftime nga Gjykata dhe institucione tjera
- **17 (shtatëmbëdhjetë)** Thirrje për seanca gjyqësore;
- **5 (pesë)** Padi janë ushtruar kundër Kompanisë sonë;
- **5 (pesë)** Përgjigje në Padi janë dhënë nga Kompania jonë;
- **7 (shtatë)** Ankesa i kanë parashtruar konsumatorët kundër Vendimeve të gjykatave;
- **1 (një)** Kërkesë nga një konsumatorë i cili ka kërkuar që ti fshihet borxhi nga Kartela e klientit;
- **1 (një)** Kërkesë nga Prokuroria Themelore e Prizrenit;
- **1 (një)** Ekspertizë në favor të Kompanisë;
- **Nuk ka pasur** Ekspertizë kundër Kompanisë;
- **1 (një)** Ujdi gjyqësore;
- **Nuk ka pasur** Urdhëresë për pagesë të garancisë apo taksave të ndryshme;
- Nga Gjykatat në total kanë ardhur **92 (nëntëdhjetë e dy)** shkresa.

Punët tjera nga Zyra Ligjore

Konsultimin, analizimin dhe studimin e Projektligjeve, Ligjeve të vjetra dhe atyre të reja, Udhëzimeve Administrative, Rregulloreve dhe materialeve tjera lidhur me përgatitjet teorike për nxjerrjen e Rregulloreve të ardhshme të cilat duhet të harmonizohen me Ligjet dhe Aktet tjera të reja; Pjesëmarrje në Komisionin Disiplinorë përgatitja e Konkluzioneve dhe Vendimet lidhur me përgjegjësinë e punonjësve sipas Rregullores mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të Kompanisë;

Janë përgatitur Kërkesa, Ankesa, Njoftime, Deklarata të ndryshme, për institucione të ndryshme; Janë dhënë Përgjigje në Ankesa, Përgjigje në Padi, Përgjigje në Kërkesa të punëtorëve, përgjigje ndaj konsumatorëve, përgjigje ndaj institucioneve të ndryshme si dhe personave tjerë fizik për çështje të ndryshme;

Janë bërë përkthime të Konkurseve të Kompanisë nga Gjuha Shqipe në Gjuhën Boshnjake; Pjesëmarrje në Komisione për pranimin e punëtorëve në punë, dhe komisione tjera brenda Kompanisë;

Kontakte të vazhdueshme me Përmbauesit Privat edhe pse jo në masën e nevojshme, sidomos me Përmbauesit nga Malisheva dhe Suhareka, kjo si pasojë e mungesës së automjeteve për transport;

**PUNËT E KRYERA ME PËRMBARUESIT PRIVAT
JANAR – DHJETOR 2018 NJËSIA PUNUESE PRIZREN**

	Propozime për përmbarime	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Tërheqje	Të përfunduar
Janar	10	1	1	11	/	10
Shkurt	12	1	1	1	/	4
Mars	/	/	/	1	/	/
Prill	17	/	/	2	/	1
Maj	107	6	6	8	1	3
Qershor	110	5	5	14	/	2
Korrik	57	5	5	16	/	4
Gusht	00	9	8	13	3	8
Shtator	41	6	6	16	3	4
Tetor	55	4	4	30	5	5
Nëntor	40	6	5	26	2	4
Dhjetor	51	10	10	11	2	5
Totali	500	53	51	209	16	50

Nga Njësia Punuese e Prizrenit me Përmbaruesit Privat janë kryer këto punë:

- Te përmbaruesit i kemi dërguar **500 (pesëqindtë)** lëndë me propozim për përmbarim.
- Nga konsumatorët janë parashtruar **53 (pesëdhjetë e tri)** prapësime.
- Nga kompania janë dhënë **51 (pesëdhjetë e një)** përgjigje në prapësime.
- Janë lidhur **209 (dyqindtë e nëntë)** marrëveshje me debitorë.
- **16 (gjashtëmbëdhjetë)** lëndë të tërhequra.
- Janë përfunduar **50 (pesëdhjetë)** lëndë.

JANAR – DHJETOR 2018 NJËSIA PUNUESE MALISHEVË

	Propozime për përmbarime	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Tërheqje	Të përfunduar
Janar	20	/	/	4	1	/
Shkurt	/	1	1	6	/	1
Mars	14	/	/	3	/	/
Prill	/	/	/	5	1	7
Maj	/	/	/	2	/	9
Qershor	10	/	/	4	/	2
Korrik	/	/	/	3	/	5
Gusht	/	/	/	1	/	/
Shtator	/	/	/	4	/	3
Tetor	15	1	1	8	/	8
Nëntor	/	/	/	4	/	6
Dhjetor	/	/	/	6	/	2
Totali	59	2	2	50	2	43

Nga Njësia Punuese e Malishevës me Përmbauesit Privat janë kryer këto punë:

- Në këtë Gjykatë i kemi dërguar **59 (pesëdhjetë e nëntë)** lëndë me propozim për përmbauesit.
- Nga konsumatorët janë bërë **2 (dy)** prapësime.
- Nga kompania janë bërë **2 (dy)** përgjigje në prapësim.
- Janë lidhur **50 (pesëdhjetë)** marrëveshje me debitorë.
- Janë tërhequr **2 (dy)** lëndë.
- Janë përfunduar **43 (dyzet e tri)** lëndë.

JANAR – DHJETOR 2018 NJËSIA PUNUESE SUHAREKË

	Propozime për përmbauesit me	Prapësime	Përgjigje në prapësim	Marrëveshje	Tërheqje	Të përfunduar
Janar	9	1	1	5	1	1
Shkurt	8	/	/	7	/	2
Mars	13	/	/	10	/	2
Prill	13	2	2	6	/	2
Maj	/	1	1	6	/	11
Qershor	8	1	1	4	/	3
Korrik	8	0	0	3	/	2
Gusht	/	4	4	3	/	1
Shtator	/	0	0	3	/	3
Tetor	15	1	1	8	/	8
Nëntor	/	/	/	4	/	6
Dhjetor	/	/	/	6	/	2
Totali	74	10	10	65	1	43

Nga Njësia Punuese e Suharekës me Përmbauesit Privat janë kryer këto punë:

- Në këtë Gjykatë i kemi dërguar **74 (shtatëdhjetë e katër)** lëndë me propozim për përmbauesit.
- Nga konsumatorët janë parashtruar **10 (dhjetë)** prapësime.
- Nga kompania janë dhënë **10 (dhjetë)** përgjigje në prapësim.
- Janë lidhur **65 (gjashtëdhjetë e pesë)** marrëveshje me debitorë.
- Është tërhequr **1 (një)** lëndë.
- Janë përfunduar **43 (dyzet e tri)** lëndë.

JANAR – DHJETOR 2018 NJËSIA PUNUESE DRAGASH

	Propozime për përbarime	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Tërheqje	Të përfunduara
Janar	/	1	1	/	/	1
Shkurt	/	1	1	/	/	1
Mars	/	/	/	/	/	/
Prill	/	/	/	/	/	/
Maj	17	/	/	/	/	/
Qershor	/	2	2	/	/	/
Korrik	/	/	/	2	/	/
Gusht	/	2	2	2	/	1
Shtator	/	/	/	1	/	/
Tetor	/	1	1	1	/	1
Nëntor	/	1	1	2	1	1
Dhjetor	/	/	/	1	/	/
Totali	17	7	7	9	1	5

Nga Njësia Punuese e Dragashit me Përbaruesit Privat janë kryer këto punë:

- Në këtë Gjykatë për këtë tremujorë janë dërguar **17 (shtatëmbëdhjetë)** lëndë me propozim për përbarim.
- Nga konsumatorët janë parashtruar **7 (shtatë)** prapësime.
- Nga kompania janë dhënë **7 (shtatë)** përgjigje në prapësime.
- Janë lidhur **9 (nëntë)** marrëveshje me debitorë.
- Është tërhequr **1 (një)** lëndë
- Janë përfunduar **5 (pesë)** lëndë.

LËNDËT TË CILAT JANË NË PROCEDURA GJYQËSORE DHE TË CILAT E KËRCËNOJNË KOMPANINË

Nr.	C.nr.	Kontesti	Vlera	Vërejtje
1.	C.nr. 1214/12, datë 05.03.2013	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Ende e pacaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë
2.	C. nr. 116/03, datë 08.05.2013	Padi për kompensim dëmi	Dëmshpërblimi ende i pacaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë
3.	C.nr. 286/14, datë 03.06.2015	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Dëmshpërblimi ende i pacaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë

4.	A.nr. 420/2015, datë 03.04.2017	Padi – Kontest lidhur me borxhin e ujit	Kontest administrativ	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë
5.	C.nr. 1200/2013, 16.12.2013	Padi – kontest lidhur me borxhin e ujit	Vlera e kontestit 571 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
6.	C.nr. 170/18, datë 14.09.2018	Padi – kompensim dëmi	Vlera e kontestit 1,170.00 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
7.	C.nr. 471/2017, datë 06.10.2017	Padi – kompensim dëmi	Vlera e kontestit 3200.00 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
8.	C.nr. 416/18, datë 24.05.2018	Padi – Kontest pronësor	Vlera e kontestit 500 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
9.	C.nr. 99/16, datë 06.03.2018	Padi – Kontest pronësorë	Vlera e kontestit 10,000 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Dragash
10.	C.nr. 364/16, datë 12.10.2016	Padi – Kontest pronësorë	Vlera e kontestit 3200 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Suharekë
11.	C.nr.1173/18, datë 10.09.2018	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Vlera e kontestit 3500 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren

Aktivite e Zyrtarit për Siguri dhe Shëndetin në Punë për Vitin – 2018

Gjatë vitit 2018 janë realizuar vizitat e objekteve të Kompanisë lidhur me mirëmbajtjen dhe gjendjen tyre,, janë kontrolluar të gjitha objektet në njësinë e Prizrenit, siç janë objekti i “Rezervari i shpatit”, “Filtrat”, “Kuagulatorët”, objektet te “Mulliri i vjetër”, objektet dhe burimet e “40 Burimet”, objekti dhe “40 Burimeve - II “ ku janë kontrolluar gjendja e tyre, pastërtia dhe mirëmbajtja e objekteve si dhe hapësira për rreth objekteve, si dhe është bërë kontrollimi i aparateve kundër zjarrit dhe gjendja e tyre.

Në këtë periudhë përkatësisht në muajin Janar për shkak të defektit të instalimit elektrik është djegur automjeti kombi për shërbimin e ekipeve të montimit dhe demontimit dhe në këtë rast janë informuar me shërbimi i zjarrfikëseve, policia të cilët janë duke u marrur me rastin, si dhe për rastin ne fjale e gjithë ekipi i montim demontimit kanë paraqitur deklarata me shkrim lidhur me paraqitjen e zjarrit.

Gjatë këtij viti kemi pasur edhe lëndime në vendin e punës, janë vizituar punëtorët e lënduar në vendin e punës, lëndimi i punëtorit ka ardhur gjatë leximit të ujëmatësit, riparimin e defektit në pompat e ujit të “Pusi atit” njëherit janë marrë deklarata punëtorëve pas lëndimit, por gjendja shëndetësore e punëtorit është e mirë dhe pa pasoja në punë.

Gjatë këtij viti vazhdimisht janë kontrolluar objektet e Kompanisë, janë kontrolluar kohë pas kohe të gjitha aparatet kundër zjarrit, është kontrolluar gjendja e hidrantëve të ujit në kompani prandaj kemi nevojë për të pasur gypat e gomës për ti vendosur në hidrantë për raste nevojë.

Në këtë periudhë përmes firmës kontraktuese “SAP-Internacional sh.p.k” në Prizren kemi bërë servisimin e aparateve kundër zjarrit nëpër të gjitha njësitë sipas dokumentacionit të pranimit-dorëzimit për 70 aparate.

Njësia Prizren ka 41 aparate kundër zjarrit, Njësia Malishevë ka 15 aparate kundër zjarrit Njësia Suharekë ka 9. aparate kundër zjarrit Njësia Dragash ka 5. aparate kundër zjarrit

Në këtë periudhë është realizuar një test-trajnim për lëmin e sigurisë dhe shëndetin në punë, testi është organizuar nga kompania e specializuar për siguri dhe shëndet në punë HSK Ilc Prishtinë.

Gjatë kontrollimit të vazhdueshëm të punëtorëve në vendin e punës është paraqitur njoftim lidhur për mos përdorimin e mjeteve mbrojtëse në punë nga ana e punëtorëve të shërbimit operativ duke kërkuar nga Udhëheqësi i njësisë së Prizrenit të rritë kujdesin ndaj punëtorëve në përdorimin e helmetave gjatë realizimit të punimeve.

Gjatë tërë vitit janë vizituar punëtorët gjatë realizimit të punimeve në ndërrimin e gypave dhe ndërrimin e ndërprerësve, njëherit janë kontrolluar edhe punëtoret e kompanisë ku kanë realizuar punime në bashkëpunim me firmën kontraktuese Infra-plus në vendin në afërsi të sheshi i Lidhjes së Prizrenit.

Aktivitetet e Shefit të Sigurimit Fizik të Objekteve dhe Administrator i Rojës për vitin 2018

Çdo muaj janë përpiluar oraret e punës për rojet në çdo objekt ku kujdestarohet 24 h me tre (3) ndërrime .

Në përputhje me Ligjin e punës Nr. 03/L-212 Neni 56 për Paga shtesë, për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, të punësuarve roje për angazhimet shtesë janë paguar në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës.

Çdo muaji janë realizuar vizita/kontrolle të vazhdueshme brenda dhe jashtë orarit të punës, në kohë të pacaktuar nëpër të gjitha objektet të cilat sigurohen nga kujdestaret – roje (24/h) në pikat e Prizrenit:40 BURIMET, MULLIRI I VJETËR, SHPATI, BUNARI 1, DREJTORIA dhe KOAGULATORET.

Detyrat dhe përgjegjësit e Rojeve në njësinë e Prizrenit janë plastifikuar në format A3, dhe janë vendosur në mure brenda objekteve ku kujdestarohen nga Rojet.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe kohore të gjitha objektet të cilat kujdestarohen gjatë 24 h në njësinë e Prizrenit janë vendosur ndriçues nëpër objektet ku ka pasur nevojë për ndriçim.

Në vazhdimësi janë kryer vizita në të gjitha objektet e njësisë punuese dhe për gjendjen e tyre janë njoftuar me shënim zyrtar udhëheqësit e shërbimeve përkatëse të kompanisë.

Në objektin: “40 Burimet” është bërë instalimi i kamerave për t’ia mundësuar Kujdestarëve – roje monitorimin sa më të lehtë të objektit dhe për rreth tij në kohë prej 24 h, gjithashtu po në këtë objekt mirëmbajtja nga rojet është duke u bërë në mënyrë shumë të mirë.

Te “Mulliri i Vjetër” gjatë gjithë kohës është inspektuar objekti, ku sipas kushteve që objekti posedon është mbajtur në mënyrë më të mirë të mundshme.

Gjithashtu është bërë një Shënim Zyrtar apo Njoftim rreth gjendjes së objektit të Depos, e cila depo gjendet në hapësirën e këtij objektit në fjalë.

Te “Shpati” është instaluar ndriçimi në hapësirën e jashtme, që gjatë natës kujdestari – roje ta ketë më të lehtë përcjelljen e gjendjes përbrenda dhe për rreth hapësirës së objektit.

Te "Bunari 1" janë vendosur dy reklamat e reja me dimension prej një metër katror (1m²), sipas kërkesës së Inspektoratit të Komunës së Prizrenit.

Vizitë të kohëpaskohshme gjatë tërë vitit në objektet: në Drejtorin e Njesisë së Malishevës, Banjë, Bubël, Gurbardh, Lladroc dhe Temeqinë, në drejtorin e Suharekës, Pusi i Atit, Studenqan, në Rezervuzrin e ujit në Samadraxhë dhe në Baçevc, dhe në Drejtorin e njesisë së Dragashit, Filtrat, Brezne dhe Plavë.

Raport rreth punës së zyrës së teknologjisë informative për 2018

- Asistencë profesionale për funksionimin normal dhe optimal të rrjetit kompjuterik në bazë dhe në njësi të kompanisë.
- Ndërhyrje në Ueb Faqe 53 herë; Njoftime për konsumatore, gjithsejtë 35, ngarkim i dokumenteve, konkurseve gjithsejtë 18.
- Ndërhyrje në Bazë (print, server, vpn router, klientë, fotokopje) : 2675 herë.
- Përkujdesje për qasjen e Kompanisë në rrjetin e internetit.
- Përkujdesje për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës së serverit qendror, programit NAVISION, serverave të Njësive, serverit të GIS sistemit dhe sigurisë së të dhënave.
- Asistencë teknike për funksionimin normal të rrjetit telefonik lokal dhe fiks.
- Planifikim i infrastrukturës së mëtutjeshme në bazë të nevojave dhe kërkesave të Kompanisë.
- Riparim harvderik dhe softuerik të pajisjeve kompjuterike, programeve aplikative operacionale që shfrytëzohen në Kompani.
- Mbikëqyrje rreth zbatimit të kontratave të furnizimeve dhe serviseve të pajisjeve kompjuterike e pajisjeve të ngjashme teknike.
- Përkujdesje për garancionet e pajisjeve dhe dërgimin e pajisjeve të amortizuara për asgjësim në Depo.
- Funkcionalizim i Gis Serverit dhe instalim i programeve të kërkuara nga punëtorët e GIS, (.net, postgree sql etj.)
- Shtrirje e kanaleve dhe rregullim i infrastrukturës së rrjetit në zyrën e faturave, korridor dhe zyrave në katin përdhese.

PROBLEMET GJATË PROCESIT TË PUNËS

Vazhdojnë të jenë problem lëndët e lartcekura të cilat e kërcënojnë Kompaninë ku tri lëndë kanë bënë me kontest nga marrëdhënia e punës ndërsa njëra me kompensim dëmi, kontest pronësor dhe kontest lidhur me borxhin e ujit.

Gjatë procesit të punës Zyra Ligjore ballafaqohet me probleme të natyrave të ndryshme, ndër të cilat mundë ti përmendim:

Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, respektivisht Neni 360, Paragrafi 1, Nënparagrafi 1.1, e parasheh afatin njëvjeçarë të parashkrimit për ujë të pijes, me ç`rast kompanisë po i shkakton dëme të konsiderueshme materiale, pasi që gjykata në shumicën e Vendimeve të cilat po i merr po thirret pikërisht në këtë dispozitë, ndërsa kompania për këto borxhe ka qenë e ngarkuar dhe ka paguar TVSH.

Deri te përbarimi i lëndës përbaruesi has në probleme të ndryshme duke filluar nga gabimet në evidentimin e konsumatorëve, ku në propozim për përbarim figuron emër tjetër, ndërsa shfrytëzues i shërbimeve të ujit është person krejt tjetër.

Mungesa e numrave personal gjithashtu ndikon në vonesa për përbarimin e lëndëve.

Pasaktësia e adresave të vendbanimit të konsumatorëve gjithashtu ndikon në vonesa për përmbartimin e lëndëve.

Faturimi në emra të vdekurve, sjellë humbje kohe dhe probleme tjera përcjellëse, pasi që të njëjtëve duhet të ju caktohen përfaqësues të përkohshëm.

Kyçjet ilegale të konsumatorëve për kompaninë janë të kushtueshme, mirëpo Vendimet e gjykatave në aspektin e disiplinimit të konsumatorëve kanë dhënë rezultate pozitive edhe pse ato ende janë rezultate fillestare.

Rastet sociale të konsumatorëve gjithashtu na paraqesin problem, sepse neve jemi të detyruar që ti tërheqim propozimet për përmbartim kur bëhet fjalë për rastet e rënda sociale, e që shpenzimet për taksat e përmbartimit bien mbi kompaninë.

Probleme na paraqesin edhe rastet kur edhe pse konsumatori është shkyçur, faturimi vazhdon, dhe me këtë dëmtohet konsumatori por edhe kompania, sepse ne ngarkohemi me TVSH dhe njëkohësisht me veprime të tilla dëmtohet edhe imazhi i kompanisë.

Propozim për zgjidhjen e problemeve

